



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 376 Akti

Nr. 476 Vendimi  
Tiranë, më 16.11.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Kryesuese
<b>Olsi Komici</b>	Relator
<b>Xhensila Pine</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 11.11.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Eda Kaja**, gjyqtare në Gjykatën e Rrethin Gjyqësor Durrës, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016.

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Eda Kaja, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike, në tërësinë e tij, vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Eda Kaja, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Eda Kaja, ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit është shortuar në datën 16.12.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët, Valbona Sanxhaktari, Olsi Komici dhe Xhensila Pine, ku relator i çështjes u zgjodh komisioneri Olsi Komici.
3. Me vendimin e datës 23.1.2020, trupi gjykues filloi hetimin administrativ bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Eda Kaja, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Valbona Sanxhaktari. Në respektim të legjislacionit në fuqi u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Gerrit Sprenger.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga relatori i çështjes në fillim të hetimit administrativ janë administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim, KLGj).
5. Nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe është nisur një hetim administrativ i thellë dhe i gjithanshëm me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin e relatorit të çështjes në datën 12.10.2021, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Eda Kaja vetëm për kriterin e pasurisë, njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative.
7. Subjekti i rivlerësimit u njoftua, në datën 15.10.2021, mbi përbërjen e trupit gjykues, mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
8. Subjekti i rivlerësimit, në datën 1.11.2021, depozitoi shpjegimet e saj dhe i kërkoi Komisionit njohjen me rezultatet e hetimit administrativ për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, kontrollin e figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, si dhe përfundimin e procesit administrativ të rivlerësimit bazuar në të tri kriteret e vlerësimit. Subjekti, në datën 4.11.2021, nëpërmjet postës elektronike dërgoi edhe disa prova të tjera në lidhje me rezultatet e dërguara nga Komisioni.
9. Komisioni, nëpërmjet postës elektronike në datën 8.11.2021, njoftoi subjektin e rivlerësimit se lidhur me kërkesën e saj për riçeljen të hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera, do të vlerësojë shpjegimet dhe provat që do të jepen nga subjekti para dhe gjatë seancës dëgjimore dhe në varësi të peshës që ato do të kenë, në lidhje me rezultatet e hetimit, pas seancës dëgjimore dhe përpara marrjes së vendimit përfundimtar, do të procedojë me marrjen e vendimit përkatës

për riçeljen ose jo të hetimit edhe për dy kriteret e tjera. Gjithashtu, subjekti u ftua në seancë dëgjimore, e cila do mbahej në datën 11.11.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

10. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 11.11.2021, ora 10:00, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, sipas njoftimit të bërë më parë nga Komisioni, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

11. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe e shoqëruar nga avokatja znj. R.Z., për të cilën deklaroi përfaqësimin e saj në seancë me deklaram. Ajo parashtrroi shpjegimet e saj në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit Eda Kaja, kërkoi marrjen në konsideratë të provave dhe shpjegimeve që subjekti ka dhënë në lidhje me kriterin e pasurisë, si dhe riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e figurës dhe atë profesional dhe në përfundim, konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

12. Znj. Eda Kaja ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

14. Për subjektin e rivlerësimit Eda Kaja, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin vetëm kriterin e vlerësimit të pasurisë.

15. Pavarësisht se sipas ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

#### **A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

16. Subjekti i rivlerësimit, në zbatim të nenit 31/1<sup>1</sup>, rezulton se ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, datë 28.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

---

<sup>1</sup>Subjekti i rivlerësimit ka detyrim të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë në ILDKPKI.

17. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport<sup>2</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Eda Kaja, e cila është subjekt deklarues që prej vitit 2003. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, për çdo aset të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

## A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

18. Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- b) deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike, private dhe individë;
- e) deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet/provat e dhëna në seancën dëgjimore.

19. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

- Pasuritë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të në deklaratën e pasurisë *Vetting*

### **1. Apartament<sup>3</sup>, me sip. 115.9 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*” (ish-rruga “\*\*\*\*”), shk. \*\*\*\*, k. \*\*\*\*, ap. \*\*\*\*, Durrës**

Apartamenti është regjistruar në ZVRPP-në Durrës në emër të shtetasës Eda Kaja. Vlera: 10,000 euro. Pjesa takuese: 100%.

1.1 Burimi i krijimit: përfituar si bashkëpronare truall, sipas kontratës së shkëmbimit, datë 16.4.2009<sup>4</sup>. Subjekti ka deklaruar, gjithashtu, në deklaratën *Vetting* se: “Në këtë shtëpi jetojnë dhe sot dhe se janë shpenzuar edhe 10,000 euro të cilat janë marrë kredi për punime. Për punimet e kësaj shtëpie janë përdorur dhe të ardhurat e marra nga shitja e një apartamenti”.

<sup>2</sup>Raporti nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2018, i ILDKPKI-së.

<sup>3</sup>Apartamenti me nr. pasurie \*\*\*\*, vol. \*\*\*\*, f. \*\*\*\*, z. k. \*\*\*\*.

<sup>4</sup>Kontratë shkëmbimi nr. \*\*\*\*, datë 16.4.2009.

## **Garazh<sup>5</sup> me sip. 19.4 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi të pandarë me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.**

Nuk është përcaktuar vlerë. Pjesa takuese: 50%.

Burimi i krijimit: përfituar nga kontrata e shkëmbimit<sup>6</sup>, datë 16.4.2009, si rezultat i trashëgimisë. Subjekti ka deklaruar po në deklaratën *Vetting se: “Aktualisht këtë garazh e disponojmë familjarisht edhe sot që nga viti 2005”*.

### **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

1.2 Në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar truallin me sip. 547.75 m<sup>2</sup> në bashkëpronësi me 13 bashkëpronarë të tjerë në adresën lagjja \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, Durrës, me burim: trashëgimi e rrjedhur nga nëna e saj, e kthyer me vendim nr. \*\*\*, të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Durrës.

1.3 Subjekti ka depozituar dokumentacionin<sup>7</sup> e përfitimit të truallit, i cili më pas i është dhënë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., nga ku është përfituar apartamenti dhe garazhi (vendparkimi) i lartpërmendur.

1.3.1 Është depozituar, gjithashtu, nga subjekti kontrata e shkëmbimit<sup>8</sup>, datë 16.4.2009, lidhur ndërmjet bashkëpronarëve Eda Kajo (C.), M.C. etj., dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Nga kjo kontratë subjekti Eda Kaja ka përfituar:

- i) apartament me sip. 115.9 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, kati \*\*\*, në pronësi individuale;
- ii) njësi nr. \*\*\*, me sip. 23.79 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi me bashkëpronaren tjetër R.H. dhe shoqërinë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., ku bashkëpronarët Eda Kaja dhe R.H. përfitojnë bashkëpronësinë për 22.5 m<sup>2</sup>, ndërsa shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ruan pronësinë për 1.29 m<sup>2</sup>;
- iii) garazh G. \*\*\*, me sip. 19.4 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi të Eda Kajës dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në 1/2 pjesë secila. Në këtë bashkëpronësi Eda Kaja ka 10 m<sup>2</sup>, ndërsa shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k mbi 9.4 m<sup>2</sup>.

1.3.2 Këto pasuri dhe pronësiat përkatëse janë konfirmuar edhe nga ASHK-ja Zyra Vendore Durrës me shkresat datë 23.10.2017, 8.1.2020 dhe 13.8.2021<sup>9</sup>.

1.4 Në lidhje me njësinë me sip. 23.79 m<sup>2</sup>, rezulton se me kontratën premtim-shitje, datë 12.11.2008<sup>10</sup> (të depozituar me dosjen *Vetting* nga subjekti), shitësit Eda Kaja, M. C. dhe R. H.

<sup>5</sup>Garazh me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*.

<sup>6</sup>Kontratë shkëmbimi nr. \*\*\*, datë 16.4.2009.

<sup>7</sup>Vendim nr. \*\*\*, datë 12.8.1993, i KKK Pronave për njohjen e të drejtës së pronësisë trashëgimtarëve të Sh.H. dhe S. e I. H. (ku përfshihet edhe E.C.), mbi një ndërtesë dy kate ndodhur në lagjen nr. \*\*\*, Durrës; vendim nr. \*\*\*, datë 31.1.1995, i KKK Pronave Durrës, ku 11 trashëgimtarë, përfshirë edhe E.C. i njihet dhe i kthehet trualli i lirë me sip. 250 m<sup>2</sup> dhe kompensim në natyrë sipërfaqja e truallit me sip. 122 m<sup>2</sup>; vendim nr. \*\*\*, datë 14.5.2001, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për plotësimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 12.8.1993, të KKK Pronave, për njohjen e të drejtës së pronësisë mbi truallin me sip. 547.75 m<sup>2</sup>, i ndodhur nën ndërtesën dykatëshe të kthyer me vendim KKKP-je, trashëgimtarëve të Sh., S. dhe I.H.; kontratë shkëmbimi nr. \*\*\*, datë 16.4.2009, lidhur midis palëve shkëmbyese bashkëpronarët e truallit R.H., N.H., I.H., M.C., Eda Kajo (C.) që kanë në pronësi një truall me sip. 547,75 m<sup>2</sup> dhe shoqërisë ndërtimore “\*\*\*\*” sh.p.k. që ka në pronësi një ndërtesë 9 kate + 1 kat dyqan + 1 kat garazh ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Durrës.

<sup>8</sup>Kontratë shkëmbimi nr. \*\*\*, datë 16.4.2009.

<sup>9</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2017, nga ASHK-ja Durrës e depozituar në ILDKPKI gjatë procesit *Vetting* dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.8.2021 dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.1.2020, nga ASHK-ja Durrës e depozituar nga subjekti me pyetësin nr. 1.

<sup>10</sup>Kontratë premtim-shitje nr. \*\*\*, datë 12.11.2008, me palë shitëse R.H., M. C. (C.) e Eda Kaja dhe palë blerëse I.Ll. Në kontratë shitësit kanë deklaruar se në dyqanin nr. \*\*\*, me sip 22.5 m<sup>2</sup>, 11.25 m<sup>2</sup> janë pjesë e bashkëpronësisë së R.H. ndërsa 11.25 m<sup>2</sup> janë në bashkëpronësi të M.C. dhe Eda Kaja dhe se me marrjen e dokumentit të pronësisë, do t’ia shesin dyqanin vetëm palës blerëse I.Ll. me çmimin 46,000 euro, sipas kështesave: kësti I në shumën 35,677 euro pala blerëse e ka paguar tërësisht jashtë zyrës noteriale; kësti II në shumën 4,323 euro do paguhet brenda datës 12.12.2008 me transfertë bankare ose vërtetim noterial; kësti III dhe i fundit në shumën 6,000 euro do paguhet brenda datës 30.4.2009 me transfertë bankare ose vërtetim noterial. Palët bien dakord se nga vlera e pagesës 35,677 euro, shumën 23,000 euro e marrin bashkëpronarët e truallit Eda Kaja

ia shesin njësinë me sip. 23.79 m<sup>2</sup> shtetasit I.LL., në shumën 46,000 euro, ku nga kësti i parë prej 35,677 euro, parapaguar nga blerësi jashtë zyrës noteriale, shumën prej 23,000 euro e marrin Eda dhe M.C.

1.4.1 Subjekti ka depozituar edhe kontratën e shitjes, datë 31.5.2012<sup>11</sup>, ku shitësit shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., R.H. dhe Eda C. i shesin I.LL. njësinë me sip. 23.79 m<sup>2</sup> në adresën lagjja \*\*\*, Durrës me çmimin 2,659,959 lekë, vlerë e cila është parapaguar *cash* jashtë zyrës noteriale.

1.5 Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2009, apartamentin me sip. 115.9 m<sup>2</sup>, garazhin me sip. 19.4 m<sup>2</sup> si dhe njësinë me sip. 23.79 m<sup>2</sup>, të përfituara me kontratën e shkëmbimit të vitit 2009, si dhe pjesët takuese të këtyre pasurive dhe, për këtë arsye, i ka kërkuar shpjegime subjektit me pyetësin nr. 2.

1.5.1 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar, ndër të tjera, se pasuritë në fjalë nuk i ka deklaruar në deklaratat përkatëse duke menduar se i ka deklaruar në deklaratën e vitit 2005. Për apartamentin me sip. 120 m<sup>2</sup>, subjekti ka shpjeguar se është i njëjti me atë me sip. 115.9 m<sup>2</sup>, sipas dokumentit të hipotekës dhe me ambientet e përbashkëta shkon në sip. 120 m<sup>2</sup>. Ndërsa njësinë dhe vendparkimet i ka deklaruar në vitin 2005 pa përcaktuar qartë pjesët dhe në këtë deklaram ka përcaktuar përafërsisht sip. 30 m<sup>2</sup>.

1.6 Subjekti i rivlerësimit në DIPP e vitit 2005<sup>12</sup> ka deklaruar: “Për sip. 90 m<sup>2</sup> të apartamentit me sip. 120 m<sup>2</sup> do të paguaj vlerën 37,000 euro. Në dhjetor të vitit 2005 paguar pjesa e I-rë prej 10,000 euro (kredi në NBG), pjesa tjetër do paguhet gjatë vitit 2006. Kontrata përfundimtare do bëhet më vonë (DIPP e vitit 2005 është depozituar në ILDKPKI në datë 24.3.2006, por deklarimi i mësipërm pasqyrohet në faqen 3, ku është shënuar me shkrim dore data 22.1.2007)”.

Subjekti, në po të njëjtën deklaratë, ka deklaruar: “Përfituar apartament 3+1, me sip.120 m<sup>2</sup> në tokën të cilën e kam trashëgim pjesë nga nëna ime. Toka është në bashkëpronësi e regjistruar në hipotekë në datën 17.9.2001, përfituar falas një dyqan 12 m<sup>2</sup> dhe garazh. Përfituar falas 30 m<sup>2</sup> pjesa tjetër do të paguhet. Pjesa takuese: 50%”.

1.6.1 Në DIPP-në e vitit 2006, subjekti nuk ka deklaruar pagesa për apartamentin ashtu siç ka edhe referuar në DIPP-në e vitit 2005.

1.6.2 Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale<sup>13</sup>, datë 24.8.2021, me deklarues shtetasin I.LL., i cili deklaroi se ka marrë në dorëzim dyqanin me sip. 22.5 m<sup>2</sup>, në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate 12.11.2008 dhe ka paguar tërësisht palës shitëse *cash* këstin e parë në shumën 35,675 euro dhe sipas kësaj kontrate, shumën 23,000 euro e ka marrë *cash* në dorë Eda Kaja (C.) dhe M.C.

1.6.3 Komisioni i ka kërkuar subjektit<sup>14</sup> që të shpjegojë mospërputhjen lidhur me çmimin e shitjes së njësisë për shkak se në kontratën premtim-shitje të vitit 2008, përcaktohet vlera 46,000 euro, ndërsa kontrata e shitjes e vitit 2012 përcakton si çmim shitje në vlerën 2,659,959 lekë.

1.6.4 Subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se për shkak të diferencës së kohës së lidhjes së dy kontratave, nuk ka pasur dijeni përse në kontratë është shënuar shuma 2,659,959 lekë si çmim

---

dhe M.C., ndërsa diferencën e këstit të parë në shumën 12,677 euro ta përfitojë bashkëpronarja e truallit R.H., duke iu dorëzuar kjo shumë *cash* përfaqësuesit të saj me prokurë D.H.. Bashkëpronarët M.C. dhe Eda Kaja deklarojnë se iu është paguar tërësisht çmimi i pjesës takuese të bashkëpronësisë së dyqanit nr. \*\*\*, ndërsa bashkëpronarës R.H. i njihet e drejta kreditore në shumën 10,323 euro.

<sup>11</sup>Kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 31.5.2012.

<sup>12</sup>Në faqen nr. \*\*\*

<sup>13</sup>Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 24.8.2021, e depozituar me pyetësin nr. 2.

<sup>14</sup>Shihni pyetësin nr. 2.

total i sendit, pasi vlera e saktë e shitjes është e pasqyruar në kontratën premtim-shitje prej së cilës ajo dhe babai kanë përfituar shumën totale prej 23,000 euro.

1.7 Komisioni ka hetuar dhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shtetasin I.L.L. dhe nga hetimi i kryer<sup>15</sup> nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

1.7.1 Në lidhje me garazhin me sip. 19.4 m<sup>2</sup> në bashkëpronësi me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., subjektit i është kërkuar të sqarojë qëllimin e kësaj bashkëpronësie ku subjekti Eda Kaja ka sip. 10 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi, ndërsa shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., mbi 9.4 m<sup>2</sup>.

Subjekti ka shpjeguar se pavarësisht se është bashkëpronare në pjesë të pandarë me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., prej kontratës së shkëmbimit, me mirëkuptim me njëri-tjetrin kanë përcaktuar vendin që do përdornin dhe se posti i parkimit (me 10 m<sup>2</sup>), ishte i mjaftueshëm për qëndrimin e makinës familjare.

1.8 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

- subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2009, apartamentin me sip. 115.9 m<sup>2</sup>, garazhin me sip. 19.4 m<sup>2</sup>, njësinë me sip. 23.79 m<sup>2</sup> dhe pjesët takuese të tyre, të përfituara me kontratën e shkëmbimit të vitit 2009;
- subjekti ka bërë deklaram të pasaktë të apartamentit, njësisë dhe garazhit për shkak se në DIPP-në e vitit 2005 deklaroi apartamentin me sip. 120 m<sup>2</sup>, njësi me sip. 12 m<sup>2</sup> dhe garazh (pa përcaktuar m<sup>2</sup>), ndërsa në deklaratën *Vetting* subjekti deklaroi apartament me sip. 115.9 m<sup>2</sup>, garazh me sip. 19.4 m<sup>2</sup>, ndërsa në kontratën e 2008 dhe 2012, njësia deklarohet me sip. 23.79 m<sup>2</sup>;
- subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kontratën e shitjes përfundimtare të njësisë me sip. 23.79 m<sup>2</sup>, në DIPP-në e vitit 2012;
- ka deklarime kontradiktore të subjektit lidhur me përfitimin e apartamentit me sip. 115.9 m<sup>2</sup>, për shkak se në DIPP-në e vitit 2005 subjekti deklaroi se për apartamentin me sip. 120 m<sup>2</sup> (që është i njëjti me 115.9 m<sup>2</sup>), për sip. 90 m<sup>2</sup> do paguajë vlerën 37,000 euro dhe se përfiton falas 30 m<sup>2</sup>, ndërsa në kontratën e shkëmbimit të vitit 2009 specifikohet vetëm përfitimi i apartamentit me sip. 115.9 m<sup>2</sup>, si pasojë e këmbimit të truallit të bashkëpronarëve me shoqërinë ndërtuese dhe nuk përcaktohen klauzola si ajo e deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2005;
- subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2006 pagesën e detyrimit të mbetur në shumën 27,000 euro shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. (10,000 euro deklaruar nga subjekti paguar në vitin 2005), si dhe nuk ka deklaruar burimin e kësaj shume dhe provuar ligjshmërinë e saj;
- subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse për mospërputhjen e çmimit të shitjes së njësisë me sip. 23.79 m<sup>2</sup> në bashkëpronësi, deklaruar në kontratën premtim-shitje të vitit 2008 në vlerën 46,000 euro (pjesa e përfituar në vlerën 23,000 euro) dhe kontratës përfundimtare të shitjes së vitit 2012 në vlerën 2,659,959 lekë (përfituar 1/3 ose 886,653 lekë);
- konstatohet se pasqyrimi i çmimeve të ndryshme në kontratën premtim-shitje së vitit 2008 në shumën 46,000 dhe kontratës së shitjes së vitit 2012 në shumën 2,659,959 lekë, për njësinë me sip. 23.79 m<sup>2</sup>, është bërë me qëllim shmangien e pagimit të detyrimit tatimor nga subjekti i rivlerësimit

Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

---

<sup>15</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

## Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.9 Subjekti i rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar si vijon:

1.9.1 Për mosdeklarimin e pasurive të lartpërmendura në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka shpjeguar se sipërfaqet e përfituara në bazë të kontratës së shkëmbimit i ka deklaruar pranë ILDKPKI-së në vitin 2010, kur është thirrur për shpjegime. Referuar apartamentit, ku ka filluar të banojë që në vitin 2005, deklaroi se e ka deklaruar në DIPP e vitit 2005 dhe nuk e ka vlerësuar ta deklarojë sërish në momentin kur u lidh kontrata e shkëmbimit. Subjekti e ka konsideruar si pasaktësi dhe jo qëllim për fshehje pasurie në pronësi/përdorim etj.

1.9.2 Në lidhje me pasaktësitë në deklarimin e sipërfaqeve të ndërtimit për këto pasuri, subjekti ka shpjeguar se në vitin 2005 nuk ka pasur dijeni sa do të ishin sipërfaqet e sakta dhe për këtë shkak deklarimi ka qenë i hamendësuar, por në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktësisht këto pasuri dhe sipërfaqet përkatëse sipas kontratës së shkëmbimit.

1.9.3 Për mosdeklarimin e kontratës përfundimtare të shitjes së njësisë në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka shpjeguar se shitjen e njësisë e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2008 dhe duke mos pasur pakësime/shtesa e ka konsideruar të panevojshme deklarimin në vitet e mëpasshme dhe kjo nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike apo financiare te subjekti.

1.9.4 Në lidhje me deklaratimet kontradiktore në DIPP-në e vitit 2005, ku subjekti ka deklaruar se për apartamentin me sip. 115.9 m<sup>2</sup>, për 90 m<sup>2</sup> do paguante vlerën 37,000 euro dhe 30 m<sup>2</sup> do t'i merrte falas, ndërkohë që në kontratën e shkëmbimit, datë 16.4.2009, nga ku është përfitur ky apartament, është parashikuar që përfiton apartamentin me sip. 115.9 m<sup>2</sup> pa specifikuar pagesë, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë asnjë shpjegim për këtë konstatim.

I pyetur në seancë dëgjimore në lidhje me deklarimin e vitit 2005 për përfitim të sip. 30 m<sup>2</sup> dhe pagesën për 90 m<sup>2</sup>, subjekti ka deklaruar se në momentin e plotësimit të DIPP-së të vitit 2005 nuk ka pasur dijeni se sa do të ishin metrat katrorë që do të përfitonte, ndërkohë që aty edhe do të investonte duke hyrë në një apartament të papërfunduar. Subjekti shpjegon se ishte kontrata e shkëmbimit ajo me të cilën përfitoi pasuritë dhe që u regjistrua në hipotekë.

1.9.5 Në lidhje me pagesat e bëra shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k, subjekti ka shpjeguar se meqenëse pagesa ndaj saj është kryer me bankë në vitin 2006, e ka konsideruar si veprim që evidentohet lehtësisht nga transfertat bankare. Pagesa e shumës prej 20.000 euro ka si burim të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të bashkëshortit, të konvertuar në euro dhe të depozituar në bankë.

1.9.6 Në lidhje me mospërputhjen e çmimit të shitjes së njësisë me sip. 23.79 m<sup>2</sup> pasqyruar në kontratën e premtim-shitje të vitit 2008, në vlerën 46,000 euro, ndërsa në kontratën përfundimtare të shitjes së vitit 2012 pasqyrohet çmimi prej 2,659,959 lekësh, subjekti i rivlerësimit ka dhënë të njëjtat shpjegime me ato të pyetësorit nr. 2

Gjithashtu, subjekti ka shtuar se shuma 23,000 euro duhet të merret në konsideratë nga Komisioni në analizën financiare. Po kështu, edhe ndarja e bërë nga Komisioni e pjesës takuese 1/3 nuk është ndarje e drejtë sepse nuk mund të ndahen në mënyrë të barabartë pjesët e bashkëpronarëve me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., pasi në kontratën e shkëmbimit të vitit 2009 përcaktohen qartë pjesët e bashkëpronarëve (22.5 m<sup>2</sup> subjekti dhe R.H. dhe 1.29 m<sup>2</sup>, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.).

1.9.7 Në lidhje me ekzistencën e dy kontratave për shitjen e njësisë me çmime të ndryshme që nga Komisioni është evidentuar që kjo është bërë me qëllim shmangien nga pagimi i detyrimit tatimor nga subjekti, subjekti ka shpjeguar se ky konstatim nuk qëndron, pasi ajo ka paguar detyrimin që i ka takuar përndryshe transaksioni në hipotekë nuk do mund të realizohej, çdo



veprim është kryer prej blerësit dhe çdo procedurë në ZVRPP është ndjekur prej tij dhe se subjekti nuk mban përgjegjësi për ndjekjen e këtyre procedurave.

1.9.8 I pyetur në seancë dëgjimore se cila ka qenë shumta e përfituar nga subjekti nga ky transaksion dhe se për cilën shumë është paguar tatim mbi kalimin e pronësisë, subjekti ka shpjeguar se ka përfituar vetëm shumën prej 23,000 euro që në vitin 2008 me lidhjen e kontratës premtim-shitje dhe se tatimi është paguar me depozitimin e kontratës së shitblerjes në ZVRPP-në Durrës dhe për çmimin e pasqyruar në kontratën e shitblerjes prej 2,659,959 lekësh.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

1.10 Komisioni vëren se subjekti ka pasur detyrimin të deklarojë këto pasuri në DIPP-në e vitit 2009, kur është lidhur kontrata e shkëmbimit, pasi ishte dokumenti i cili përcaktonte në mënyrë të saktë dhe të qartë pasuritë e përfituara nga subjekti dhe sipërfaqet e tyre. Gjithashtu, në deklaratimet e pasurive në DIPP-në e vitit 2005, subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaram të saktë në lidhje me sipërfaqet përkatëse.

1.10.1 Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë të pasurisë njësi me sip. 23.79 m<sup>2</sup>, pasi nuk ka deklaruar shitjen përfundimtare të saj në DIPP-në e vitit 2012, nëpërmjet kontratës së shitblerjes, e cila pasqyrore një çmim të ndryshëm, dukshëm më të vogël, nga kontrata e premtim-shitjes e vitit 2008.

1.10.2 Për deklaratimet kontradiktore të përfitimit të apartamentit me sip. 115.9 m<sup>2</sup> (ku në DIPP e 2005 deklarohet 90 m<sup>2</sup> do të paguhen 37,000 euro dhe 30 m<sup>2</sup> përfitohen falas, ndërsa kontrata e shkëmbimit pasqyron vetëm përfitimin e apartamentit pa ndonjë pagesë), subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime në prapësime, por ka shpjeguar në seancë dëgjimore se pasuritë janë fituar sipas kontratës së shkëmbimit.

1.10.3 Për pagesën e shumës 27,000 euro të deklaruar në DIPP-në e vitit 2005, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime specifike, por ka konsideruar si pagesë të vetme për apartamentin në vitin 2006 pagesën bankare prej 20,000 euro. Subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin që të deklarojë në DIPP-në e vitit 2006, pagesën e kryer në vitin 2006, pavarësisht se është kryer me bankë.

1.10.4 Referuar dy kontratave për shitjen e njësisë me sip. 23.79 m<sup>2</sup> ku pasqyrohen dy çmime të ndryshme, (në atë të premtim-shitjes të vitit 2008, pasqyrohet çmimi 46,000 euro ku subjekti dhe babai i saj përfitojnë shumën prej 23,000 euro, ndërsa në kontratën e shitjes të vitit 2012 ku pasqyrohet çmimi i shitjes 2,659,959 lekë), subjekti ka dhënë shpjegime kontradiktore.

Subjekti ka deklaruar se nuk ishte në dijeni përse kjo vlerë është shënuar në këtë kontratë (vlera 2,659,959 lekë në kontratën e shitblerjes të vitit 2012), pasi vlera e saktë është 46,000 euro (ku subjekti ka përfituar 23,000 euro), por Komisioni vëren se subjekti ishte palë në këtë kontratë dhe e ka nënshkruar atë duke pasur dijeni të plotë, në lidhje me elementët e kontratës, ku njëri prej tyre ishte edhe çmimi prej 2,659,959 lekësh.

1.10.4.1 Gjithashtu nga ana tjetër, pavarësisht padijenisë së pretenduar nga subjekti në lidhje me vlerën 2,659,959 lekë, duke menduar se përfaqëson shumën e mbetur pa shlyer, në asnjë pikë të kësaj kontrate nuk është e përcaktuar ndonjë klauzolë e veçantë, që shumta e pasqyruar përcakton diferencën e mbetur për bashkëpronaren tjetër, por është lidhur si kontratë tripalëshe, ku çmimi total është i mirëpërcaktuar.

1.10.4.2 Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të pretendimeve të saj, ka depozituar në prapësime dhe gjatë seancës dëgjimore të njëjtën deklaratë noteriale të datës 3.11.2021<sup>16</sup> me deklarues z. M.Rr., noteri i cili ka përpiluar kontratën premtim-shitje të vitit 2008 dhe kontratën e shitjes të vitit 2012, ku deklarohet, ndër të tjera, se: “... me kontratën e shitblerjes së vitit 2012

<sup>16</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 3.11.2021.

*çmimi i shitblerjes është vënë shuma e mbetur për likuidim që në mirëkuptim të palës shitëse e ka përfituar bashkëpronarja/shitëse R.H.”.*

1.10.4.3 Edhe nëse Komisioni do të konsideronte në deklarin e subjektit se prej 2,659,959 lekësh vlera (e kontratës së shitjes e vitit 2012) është diferenca që do të përfitonte bashkëpronari R.H., kjo nuk qëndron për faktin se diferenca totale që R.H. do të përfitonte nga shuma 46,000 euro do ishte 23,000 euro dhe e llogaritur me kursin e këmbimit<sup>17</sup> do të ishte 23,000 euro x 139.09 = 3,199,070 lekë, vlerë kjo shumë më e lartë se vlera e pretenduar nga subjekti.

1.10.4.4 Komisioni, duke marrë për bazë deklarinimet e subjektit në seancën dëgjimore se ka përfituar shumë 23,000 euro në vitin 2008 me kontratën e premtim-shitjes për të cilën nuk ka paguar tatim dhe se nga kontrata përfundimtare e shitjes e vitit 2012, për të cilën është paguar tatimi, subjekti nuk ka përfituar të ardhura, nuk i përfshiu në analizën financiare këto të ardhura duke i llogaritur në vlerën 0 (zero) lekë. Shuma 23,000 euro nuk plotëson kushtin e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës për t’u konsideruar e ardhur e ligjshme.

1.11 Në lidhje me ekzistencën e dy kontratave me çmime të ndryshme, ku në kontratën përfundimtare të shitjes të vitit 2012 pasqyrohet një çmim shumë herë më ulët se në kontratën e premtim-shitjes së vitit 2008, Komisioni krijon bindjen se nga subjekti janë kryer veprime fiktive me qëllim shmangien e pagimit të detyrimeve tatimore.

**Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pamjaftueshëm dhe të pasaktë të pasurive apartament, njësi shërbimi dhe garazh në deklaratat periodike, ndër vite, në kundërshtim me pikën 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.**

Subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime fiktive me lidhjen e dy kontratave me çmime të ndryshme për shitjen e të njëjtës pasuri, njësisë me sip. 23.79 m<sup>2</sup>, duke pasqyruar në kontratën përfundimtare të shitjes së vitit 2012 një çmim shumë herë më të ulët se çmimi i pasqyruar në kontratën e premtim-shitjes së vitit 2008, me qëllim shmangien nga pagimi i tatimit mbi të ardhurat për çmimin real të përfituar.

1.12 Në lidhje me vlerën e investuar në apartamentin me sip. 115.9 m<sup>2</sup>

1.12.1 Në deklarinën *Vetting* subjekti ka deklaruar se për apartamentin me sip. 115.9 m<sup>2</sup> janë shpenzuar për punime shuma 10,000 euro e marrë kredi dhe ardhurat e marra nga shitja e një apartamenti.

1.12.2 Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar se për kompletimin e apartamentit ka marrë hua shumë 10,000 euro, nga z. D.H.

1.12.3 Gjithashtu, në lidhje me shpenzimet e bëra në apartament, subjekti në pyetësorin nr. 1 ka shpjeguar se: *“Kemi bërë shpenzime në vlerën 2,000,000 lekë situacion punimesh për apartamentin me sip. 115.9 m<sup>2</sup>, ku përfshihen punime të brendshme. Kjo pagesë është bërë për shoqërinë ‘\*\*\*’, datë 5.6.2006, në ‘ProCredit Bank’ dhe të ardhurat janë marrë nga shitja e shtëpisë ku kemi jetuar së bashku me vjehrrin dhe vjehrrën pas martesës sonë (pjesa e vjehrrës + pjesa e bashkëshortit). Bashkëngjitur preventivi i punimeve dhe kontrata e shitjes nr. \*\*\*, datë 12.11.2004, vlerë e cila ka mbuluar shpenzimet e punimeve në total 2,000,000 lekë dhe një pjesë të mobilimit të shtëpisë... Lekët për arredimin e shtëpisë janë marrë me kredi, datë 23.12.2005, në NBG”.*

1.12.3.1 Subjekti ka depozituar bashkë me deklarinën *Vetting* një preventiv punimesh për apartamentin me sip. 115.9 m<sup>2</sup> lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në vlerën 2,082,471 lekë, datë 4.6.2006 (data është e shënuar me shkrim dore).

<sup>17</sup>Kursi i këmbimit të monedhës euro i datës 31.5.2012, sipas Bankës së Shqipërisë është 139.09 lekë/euro.

1.12.4 Referuar veprimeve bankare në llogarinë në ish-NBG (Abi Bank)<sup>18</sup> konfirmohet pagesa e kryer në datën 27.12.2005, në shumën 9,749.77 euro, me përshkrim “transfertë Ll.P.”, me burim kredinë në shumën 10,000 euro të disbursuar në datën 23.12.2005.

1.12.5 Në llogarinë në ProCredit Bank<sup>19</sup> konfirmohet pagesa e kryer në datën 5.6.2006, në shumën 20,000 euro, me përshkrim “E. Kaja për “\*\*\*”, këst shtëpie”. Shuma e përdorur në këtë transfertë ka si burim 41,000 euro të depozituara *cash* në datën 8.10.2005 nga subjekti i rivlerësimit. Për këtë vlerë, subjekti në pyetësin nr. 2 ka shpjeguar se ka si burim depozitat e mbyllura në fund të vitit 2004 (605,000 lekë tërhequr nga depozita e bashkëshortit në datën 17.12.2004 dhe në vlerën 5,000 euro tërhequr nga depozita e subjektit në datën 23.11.2004) dhe shumën 4,000,000 lekë të përfutur nga shitja e apartamentit<sup>20</sup> me sip. 78.9 m<sup>2</sup>.

1.12.6 Nga verifikimi i deklaratave periodike, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar për vitin 2004, si kursime *cash* shumat e tërhequra nga depozitat bankare dhe nga shitja e apartamentit me sip. 78.9 m<sup>2</sup>.

1.12.6.1 Subjekti ka shpjeguar se në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se për apartamentin me sip. 115.9 m<sup>2</sup> ka kryer shpenzime për punime në përputhje me preventivin, punime të kryera nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., sipas kërkesës së subjektit. Vlera totale e punimeve të kryera nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. është në shumën 30,000 euro, sipas transfertave bankare si vijon: “*Transferta, datë 27.12.2005, transferuar kredia bankare e marrë në NBG, në vlerën 9,749.77 euro; transfertë, datë 5.6.2006, transferuar shuma prej 20,000 euro, me burim të ardhurash shitja e apartamentit të bashkëshortit E.K.; shuma prej 10.000 euro për arredimin është me burim të ardhurash nga huaja e marrë nga D.H. Burimi i të ardhurave për kryerjen e këtyre shpenzimeve për apartamentin (Ll. dhe arredim) ka qenë përfundimisht pjesë e të ardhurave të shitjes së apartamentit, hua marrë nga bashkëshorti im, E.K. dhe pas marrjes së kredisë bankare në NBG, në shumën 10,000 euro i ka shlyer, po në dhjetor të vitit 2005, D. shumën 7000 euro*”.

1.12.6.2 Subjekti ka depozituar edhe një deklaratë noteriale të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., z. P.Ll.<sup>21</sup>, datë 18.8.2021, i cili ka deklaruar se gjatë fazës së ndërtimit znj. Eda Kaja ka investuar vetë punime ekstra në arkitekturë dhe mobilim. Nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. nuk është deklaruar vlerë e këtyre punimeve.

1.12.6.3 Referuar veprimeve bankare në ProCredit Bank konfirmohet se në datën 3.10.2005, z. D.H. i ka transferuar shumën 10,000 euro, z. E.K. Në datën 4.10.2005, z. E.K. ka kaluar shumë 5,000 euro (nga kjo shumë) në depozitë me afat, e cila është maturuar në datën 7.11.2005 dhe më pas është tërhequr *cash*. Gjithashtu, pjesa e mbetur prej 5,000 euro është tërhequr *cash* në intervalin kohor 12.10.2005 – 3.11.2005. Në intervalin kohor 14 -18.11.2005 rezultojnë në shumën 5,960 euro pagesa të kryera me kartë.

1.12.7 Në pyetësin nr. 2, subjekti është pyetur në lidhje me veprimet bankare në llogarinë në ProCredit Bank, konkretisht është pyetur për destinacionin e tërheqjeve *cash* të shumës 5,000 euro, për periudhën 12.10.2005 – 3.11.2005, tërheqjen *cash* në datën 7.11.2005, të shumës 5,000 euro, si dhe të pagesave të kryera me kartë në intervalin kohor 14 – 18.11.2005, në shumën 5,960 euro.

Subjekti ka shpjeguar se: “*Në lidhje me tërheqjen cash, për periudhën 12.10.2005 – 3.11.2005, si dhe tërheqjet e datës 7.11.2005 dhe, po kështu, pagesa të kryera me kartë në shumën 5,960*

<sup>18</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2020, nga “ABI Bank”.

<sup>19</sup>Shkresë me nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2020, “ProCredit Bank”.

<sup>20</sup>Në llogarinë bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” (ish-Banka Italo Shqiptare) të bashkëshortit të subjektit në datën 17.11.2004 është kredituar shuma 4,200,000 lekë me përshkrimin “derdhje nga Xh.I. për shitje shtëpie”. Në datën 17.12.2004 z. E.K. ka tërhequr shumën 4,213,013 lekë, duke e mbyllur përfundimisht llogarinë.

<sup>21</sup>Deklaratë noteriale nr. \*\*\* , datë 18.8.2021, e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., e depozituar bashkë me pyetësin nr. 2.

euro në datat 14.11 – 18.11.2005 (në total në vlerën 15,960 euro) sqaroj se si burim të të ardhurave kanë shumën prej 41,000 euro [...], si dhe huan e marrë nga z. D.H., në shumën prej 10,000 euro. Nga shumat e tërhequra cash dhe pagesat me kartë, shuma prej 10,000 euro janë përdorur për arredimin e apartamentit ku unë banoj [...] dhe pjesa tjetër është rikrijuar gjendje cash në banesë”.

1.12.8 Komisioni, nga analizimi i deklaratave periodike, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime cash për periudhën 2003 – 2016. Shuma prej 15,960 euro e tërhequr cash/paguar me bankë nga subjekti në vitin 2005 është konsideruar si shpenzim në analizën financiare, nga ku shuma prej 10,000 euro është përdorur për arredimin e apartamentit.

1.12.9 Komisioni kreu analizë për mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për kryerjen e investimit.

1.12.9.1 Në vitin 2005, subjekti ka kryer shpenzime mobilimi (tetor-nëntor) me huan nga z. D.H. dhe i ka paguar në datën 27.12.2005, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. shumën 9,750 euro me kredinë e marrë në NBG. Subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për vitin 2005<sup>22</sup>.

1.12.9.2 Në vitin 2006, subjekti ka kryer pagesë në datën 5.6.2006, në shumën 20,000 euro, me përshkrim “E. Kaja për ‘\*\*\*\*’, këst shtëpie”. Shuma e përdorur në këtë transfertë ka si burim shumën 41,000 euro të depozituar cash në datën 8.10.2005 nga subjekti i rivlerësimit. Për këtë vlerë, subjekti në pyetësin nr. 2, ka shpjeguar se shuma 41,000 euro ka si burim depozitat e mbyllura në fund të vitit 2004 (shumën 605,000 lekë tërhequr nga depozita e bashkëshortit më 17.12.2004 dhe shumën 5,000 euro tërhequr nga depozita e subjektit më 23.11.2004) dhe shumën 4,000,000 lekë të përfituar nga shitja e apartamentit<sup>23</sup>, me sip. 78.9 m<sup>2</sup>.

1.12.9.3 Tërheqjet e depozitave bankare në shumat 605,000 lekë dhe 5,000 euro nuk rezultojnë të jenë deklaruar nga subjekti si shuma të kursyera cash dhe, si të tilla, nuk mund të konsiderohen si një burim i ligjshëm për krijimin e shumës 41,000 euro.

1.12.9.4 Të ardhurat nga shitja e apartamentit analizuar gjerësisht në pikën 5 të relacionit, janë marrë në konsideratë jo në vlerën 4,000,000 lekë, sikurse ka deklaruar subjekti, por vetëm në vlerën 2,000,000 lekë, për të cilat është paguar tatim në momentin e regjistrimit të pasurisë në vitin 2004. Në vitin 2004 është njohur si e ardhur e ligjshme e përfituar nga bashkëshorti i subjektit shuma 333,333 lekë ( $1/6 * 2,000,000 = 333,333$  lekë). Kjo shumë nuk është deklaruar si kursim cash për vitin 2004, ashtu sikundër pretendon subjekti dhe, për këtë arsye, nuk mund të ketë shërbyer si burim për krijimin e shumës 41,000 euro. Dhurimi i të ardhurave nga shitja e apartamentit për pjesën takuese (5/6) është marrë në konsideratë nga Komisioni në vitin 2005 në shumën 1,666,667 lekë ( $2,000,000 * 5/6$ ), sipas deklaramit të subjektit në DIPP-në e vitit 2005.

1.12.9.5 Në përfundim, për shumën 20,000 euro ose të konvertuar në 2,473,000 lekë, duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë mungesë burimesh të ligjshme në shumën 806,334 lekë ( $1,666,666 - 2,473,000 = - 806,334$  lekë).

1.13 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

- subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pagimin e shumës 20,000 euro në datën 5.6.2006, në DIPP-në e vitit 2006 dhe në deklaratën *Vetting*;

<sup>22</sup>Shihni aneks 1, analiza financiare për periudhën 2003 – 2016.

<sup>23</sup>Në llogarinë bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” (ish-Banka Italo-Shqiptare) të bashkëshortit të subjektit në datën 17.11.2004 është kredituar shuma 4,200,000 lekë me përshkrimin “derdhje nga Xh.I. për shitje shtëpie”. Në datën 17.12.2004 E.K. ka tërhequr shumën 4,213,013 lekë, duke e mbyllur përfundimisht llogarinë.

- subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime lidhur me shumën 37,000 euro deklaruar në DIPP-në e vitit 2005, për t'u paguar për sip. 90 m<sup>2</sup>;
- subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* shpenzimet e mobilimit në shumën 10,000 euro me burim huan e marrë nga z. D.H.;
- subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar vlerën totale të investuar për apartamentin me sip. 115.9 m<sup>2</sup> dhe burimet e përdorura për to;
- ka mospërputhje deklarimi lidhur me shumën 10,000 euro marrë kredi nga NBG, pasi në deklaratën *Vetting* deklaroi se është përdorur për të paguar shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. (konfirmuar edhe nga veprimet bankare), ndërsa në pyetësin nr. 2 deklaroi se kredia është përdorur për të shlyer huan e z. D.H.;
- subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, nuk kanë deklaruar në DIPP-në e vitit 2004 pjesën takuese të të ardhurave të përfituara nga shitja e apartamentit në vitin 2004, si kursime *cash*;
- subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë mungesë burimesh për investimin e kryer në apartamentin me sip. 115.9 m<sup>2</sup>, pasi në vitin 2005 rezultojnë me balancë negative dhe në vitin 2006 kanë mungesë burimesh në shumën 806,334 lekë, për pagesën e shumën 20,000 euro.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

1.14 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar në terma të analizës financiare mundësinë dhe burimin e ligjshëm për blerjen e apartamentit, shpenzimet e arredimit dhe shlyerjen e kësteve të kredisë bankare, duke evidentuar kronologjinë e veprimeve financiare të kryera prej saj.

1.14.1 Subjekti për vitin 2003 ka pretenduar gjendje likuiditeti *cash* në shumën 1,280,000 lekë, gjendje kjo që është mbartur, ndër vite, deri në vitin 2008 dhe është përdorur për investimin në banesën në Durrës.

1.14.2 Në lidhje me huan në shumën 10,000 euro marrë z. D.H. në tetor të vitit 2005, subjekti deklaroi se i ka kthyer shumën 7,000 euro në dhjetor të vitit 2005, pasi kjo shumë nuk u përdor dhe detyrimin në shumën 3,000 euro e ka paguar në vitin 2006.

1.14.3 Për të ardhurat nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi me familjarët e bashkëshortit, subjekti pretendon se shuma e përfitur në vitin 2004 është 4,200,000 lekë dhe dhurimi i pjesës takuese të shtëpisë është bërë që në momentin e shitjes. Tërheqja e shumës nuk është deklaruar si *cash* sepse është konsideruar si e evidentuar nga transaksionet bankare.

Për shpenzimet në shumën 730,338 lekë, subjekti pretendon se nuk është specifikuar nga Komisioni lloji i shpenzimeve.

1.14.4 Për mosdeklarimin e pagesës së shumës 20,000 euro në vitin 2006, subjekti e konsideron si pakujdesi, por që vërtetohet lehtësisht nga banka.

1.14.5 Subjekti pretendon se Komisioni pa të drejtë ka rënduar shpenzimet për apartamentin në shumën 3,339,981 lekë (27,000 euro), duke e vlerësuar apartamentin në shumën 67,000 euro, shumë e cila nuk përkon me asnjë dokumentacion ligjor apo financiar të administruar në dosjen e hetimit administrativ.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

1.15 Komisioni vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për gjendjen *cash* në datën 31.12.2003, në shumën 1,280,000 lekë, nuk është i bazuar sepse në DIPP-në e viti 2003 subjekti i rivlerësimit deklaroi vetëm likuiditete në bankë në shumën 280,000 lekë.

1.15.1 Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se huaja e marrë nga z. D.H. është përdorur vetëm për shumën 3,000 euro bie në kundërshtim me veprimet bankare, ku evidentohet se në datën 4.10.2005 bashkëshorti i subjektit ka kaluar shumën 5,000 euro në depozitë me afat nga huaja në shumën 10,000 euro, marrë nga z. D.H. Tërheqjet *cash* të depozitës së maturuar dhe pjesës së mbetur të huas janë deklaruar në pyetësorë nga subjekti se janë përdorur për arredim ose krijimin e gjendjes *cash* në banesë.

1.15.2 Në lidhje me të ardhurat nga shitja e apartamentit në vitin 2004, Komisioni mori në konsideratë vetëm shumën 2,000,000 lekë si të ardhura të ligjshme sepse rezultoi se nga personat e lidhur me subjektin është paguar tatim vetëm për shumën 2,000,000 lekë.

Pretendimi i subjektit se dhurimi i pjesës ka ndodhur në vitin 2004, kur është realizuar shitja, pavarësisht se nuk është deklaruar nga subjekti, provohet me kalimin e shumës në llogarinë e bashkëshortit. Mosdeklarimi i shumës së tërhequr nga banka si gjendje *cash* për vitin 2004, deklarimi i shumës së përfituar nga shitja në shumën 4,000,000 lekë dhe përdorimi i saj në vitin 2005 është marrë në konsideratë nga Komisioni sepse veprimet kanë ndodhur në fund të vitit dhe nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë kryer investime të tjera përgjatë kësaj periudhe.

1.15.3 Komisioni konkludon se shuma prej 730,338 lekësh e konsideruar si shpenzime të tjera është shpjeguar në metodologjinë e analizës financiare dhe i referohet pagesave të kryera me kartë në “ProCredit Bank”.

Komisioni mori në analizë financiare vetëm shumën 20,000 euro për vitin 2006, kaluar me bankë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

1.15.3.1 Pas prapësimeve, për sa u shpjegua më sipër, Komisioni rishikoi analizën financiare nga ku rezultoi se për pagesën e shumës 20,000 euro ose të konvertuar në 2,473,000 lekë, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë mungesë burimesh të ligjshme në shumën 473,000 lekë, pasi të ardhurat e ligjshme nga shitja e apartamentit janë në shumën 2,000,000 lekë. (2,000,000 – 2,473,000 = - 473,000 lekë).

**Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë të vlerës së investimit në deklaratat periodike dhe në deklaratën *Vetting* në kundërshtim me pikën 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.**

**Subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 473,000 lekë për pagesën në shumën 20,000 euro në vitin 2006.**

➤ Në lidhje me konfliktin e interesit

Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe administratorin/ortakun e vetëm, z. P.V.Ll., i datëlindjes 3.5.1963.

1.15.4 Për këtë qëllim, Komisioni ka administruar përgjigjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>24</sup>, e cila ka përcjellë disa vendime gjyqësore, ku rezultoi se referuar në vendimin gjyqësor nr. (\*\*\*) , datë 19.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në çështjen me ankues P.V.Ll. i datëlindjes 3.5.1963 me objekt “kundërshtimi i vendimit të mosfillimit për materialin kallëzues nr. \*\*\*, datë 4.5.2018, rezulton se është gjykuar nga gjyqtarja Eda Kaja. Në përfundim të gjykimit gjykata ka vendosur “rrezimin e kërkesës me nr. regjistri \*\*\*, datë

<sup>24</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

regjistrimi 29.5.2018, që i përket kërkuesit me objekt ‘kundërshtimi i vendimit të mosfillimit për materialin kallëzues nr. \*\*\*, datë 4.5.2018, si të pa bazuar në prova dhe në ligj’”.

1.15.5 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit është ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar<sup>25</sup> dhe, për këtë arsye, bazuar në germën “ë”, të pikës 1, të nenin 17, të Kodit të Procedurës Penale, duhet të kishte hequr dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje që në momentin që iu caktua me short. Kjo për arsye se me shtetasin P.Ll. administrator/ortak i vetëm i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., subjekti kishte një marrëdhënies interesi, duke filluar me kontratën e investimit të vitit 2002 dhe, më pas, me kontratën e shkëmbimit të vitit 2009, si dhe duke vijuar bashkëpronësinë me garazhin me sip. 19.4 m<sup>2</sup>.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

1.16 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet dhe gjatë seancës dëgjimore, dha të njëjtat shpjegime. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nuk ka pasur në asnjë rast marrëdhënie personale me z. P.Ll., as lidhje gjinore/krushqie dhe marrëdhënia juridike për ndërtimin mbi truallin e trashëguar nga familja, është lidhur me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., pavarësisht kush ka qenë ortak apo administrator i saj. Vendimi i dhënë nuk ka shqyrtuar në themel çështjen, por vetëm vendimmarrjen e organit të prokurorisë për mosfillim të procedimit dhe nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike për ndonjë palë.

1.16.1 Subjekti në seancën dëgjimore ka depozituar edhe dosjen penale të materialit kallëzues nr. \*\*\*, datë 4.5.2018, me ankues z. P.Ll. me objekt “kundërshtim vendim mosfillimi për materialin kallëzues nr. \*\*\*, datë 4.5.2018”.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

1.17 Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk qëndrojnë se pavarësisht se marrëdhënia e interesit është krijuar me shoqërinë, administrator dhe ortak i vetëm i saj ka qenë shtetasi P.Ll. dhe të gjitha veprimet në kontrata, ndër vite, ku ka qenë palë edhe subjekti, janë kryer dhe nënshkruar me këtë shtetas. Marrëdhënia e subjektit me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe administratorin P.Ll. ka filluar që në vitin 2002 me kontratën e investimit dhe ka vijuar në mënyrë të vazhdueshme deri më sot ku subjekti është bashkëpronar në pasuri të paluajtshme me këtë shoqëri (garazh). Subjekti ndodhur në kushtet e marrëdhënies së interesit, që në momentin që kjo çështje i është caktuar për gjykim, bazuar germën “ë”, të pikës 1, të nenin 17, të Kodit të Procedurës Penale, duhet të kishte deklaruar heqjen dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, pavarësisht se vendimmarrja e subjektit ka prodhuar apo jo pasoja për palët.

**Komisioni arrin në konkluzion se subjekti i rivlerësimit Eda Kaja është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit, kur ka gjykuar çështjen me palë shtetasin P.Ll., njëkohësisht administrator/ortak i vetëm i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me të cilin ka pasur dhe vijonte të kishte marrëdhënie interesi të vazhdueshme, kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.**

## **2. Depozitë në shumën 543 euro, në emër të vajzës së mitur, M.K.**

---

<sup>25</sup>“Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisive të tij publike.

Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat e familjes.

“ProCredit Bank”<sup>26</sup> konfirmon llogarinë e kursimit në emër të vajzës M.K. Nga veprimet bankare rezulton se llogaria është hapur më 19.2.2009, me depozitim e shumës 500 euro dhe është shtuar, ndër vite, me interesat e gjeneruara.

Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me këtë depozitë.

### **3. Gjendje *cash* në shumën 5,000 euro, në banesë**

Burimi i krijimit: (a) kursimet familjare ndër vite; dhe (b) kursimet e vjehrrës.

3.1 Bazuar në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, Komisioni kreu analizën e ecurisë së likuiditeteve *cash* ndër vite, shtesave/pakësimeve, me qëllim verifikimin e gjendjes së mundshme të këtyre likuiditeteve në fund të vitit 2016.

3.2 Nga verifikimi i deklaratimeve periodike rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti, nuk kanë deklaruar kursime *cash*. Subjekti deklaroi për herë të parë kursime *cash* në deklaratën *Vetting*.

3.3 Në shpjegimet e pyetësorit nr. 2, kur është pyetur në lidhje me disa transaksione bankare, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendjen *cash* në banesë, në periudhën 2003 – 2007, si në vijim, por të padeklaruar në deklaratat periodike.

Para vitit 2003, totali i likuiditeteve *cash* është në vlerën 1,000,000 lekë nga ku: gjendje *cash* në banesë 1,000,000 lekë.

Viti 2003, totali i likuiditeteve *cash* është në vlerën 1,280,000 lekë, nga ku gjendje *cash* në banesë në vlerën 1,000,000 lekë dhe vlera prej 280,000 lekësh është vendosur depozitë me afat 3-mujor, në datën 17.10.2003.

Viti 2004, totali i likuiditeteve *cash* është në vlerën 5,233,700 lekë, nga ku: gjendje *cash* në banesë 0 (zero) lekë; vlera 600,000 lekë, tërhequr dhe është mbyllur depozitë me afat, datë 17.12.2004; vlera 5,000 euro është tërhequr dhe mbyllur depozitë bankare, datë 23.11.2004; dhe vlera 4,000,000 lekë (shitja e apartamentit).

Viti 2005, totali i likuiditeteve *cash* është në vlerën 1,000,000 lekë.

Viti 2006, totali i likuiditeteve *cash* është në vlerën 1,000,000 lekë.

Viti 2007, totali i likuiditeteve *cash* është në vlerën 1,000,000 lekë.

3.4 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se nuk provohet burimi i ligjshëm i shumës *cash* 5,000 euro, deklaruar në deklaratën *Vetting*, pasi nga subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash* në asnjë deklaratë periodike gjatë periudhës 2003 – 2016.

Për këtë konstatim subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

3.5 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka dhënë të njëjtat shpjegime, si dhe ka deklaruar se shuma prej 5,000 euro ka si burim kursimet e vjehrrës nga pensioni i përfutur në Itali, e cila kishte vendosur në kohën e deklaratimit *Vetting* të kthehej në Shqipëri. Kjo shumë nuk përfaqëson kursimet e subjektit të rivlerësimit.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

---

<sup>26</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2020, nga “ProCredit Bank”.



3.6 Komisioni vëren se shpjegimet e dhëna nga subjekti mbeten në kuadër deklarativ, por konstatohet se kjo shumë nuk ka efekt në analizën financiare për periudhën 2003 – 2016 dhe nuk është përdorur si burim për krijimin e ndonjë pasurie të subjektit.

#### **4. Të ardhura nga shitja e truallit, në bashkëpronësi, me sip. 450 m<sup>2</sup>, Shkëmbi i Kavajës, Durrës**

Shitja është provuar me kontratën e shitblerjes datë 17.2.2000<sup>27</sup>. Vlera: 160,000 lekë.

4.1 Subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes datë 17.2.2000, së cilës shitësit bashkëpronarë I.H., R.H., M.C. dhe Eda C. (Kaja) i shesin blerësit, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. një tokë truall te Shkëmbi i Kavajës, Durrës, me sip. 450 m<sup>2</sup>, me çmimin 1,000,000 lekë.

4.2 Komisioni vëren se nga shuma totale prej 1,000,000 lekësh, sipas kontratës, pjesa e subjektit Eda Kaja (C.) dhe babait të saj, M.C., është 1/3 ose 333,333 lekë dhe 1/2 e kësaj shume që i përket subjektit është rreth 160,000 lekë.

4.3 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe ortakun e saj D.B. dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë<sup>28</sup>.

Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këto të ardhura.

#### **5. Të ardhura në shumën 4,000,000 lekë nga shitja e shtëpisë në emër të bashkëshortit të subjektit, vjehrrës dhe kunatit**

5.1 Subjekti, në deklaratën *Vetting*, deklaron: “Këto të ardhura na janë lënë ne për shkak se në atë shtëpi kemi jetuar me vjehrrën që kur jemi martuar. Këto të ardhura janë përdorur për punime dhe arredimin e shtëpisë, ku aktualisht jetojmë prej vitit 2005”.

5.2 Subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar këto të ardhura për herë të parë në DIPP-në e vitit 2005<sup>29</sup>, ndërkohë që po në këtë deklaratë në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale” f. \*\*\* subjekti ka deklaruar: “Pjesën e lekëve të shtëpisë, vjehrra dhe kunati na i kanë dhuruar ne, pasi në atë shtëpi kemi banuar ne”.

5.3 Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting* ka depozituar kontratën e shitblerjes me nr. \*\*\*, datë 12.11.2004, me shitës shtetasit G. (me 4/6 pjesë), A. dhe E.K. (me 1/6 pjesë) që i shesin apartamentin me sip. 78.09 m<sup>2</sup>, në Lagjen \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, Durrës, blerësit Xh.I. me çmimin 4,000,000 lekë, çmim i cili është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Bashkëngjitur kontratës është edhe certifikata për vërtetim pronësie e këtij apartamenti<sup>30</sup>.

5.4 Subjekti, në pyetësin nr. 1, ka deklaruar si adresë banimi në momentin e marrjes së detyrës: “Lagjja \*\*\*, rruga ‘\*\*\*\*’, p. \*\*\*, banesë e cila është privatizuar nga familja ime me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, lloji apartament me sip. 78.09 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi M., G., E. dhe Eda Kaja”.

5.5 ASHK - Zyra Vendore Durrës<sup>31</sup> konfirmon se apartamenti me sip. 78.9 m<sup>2</sup> ka qenë i regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve M., G., E. dhe Eda Kaja dhe, më pas, me kontratë dhurimi ka kaluar në pronësi të shtetasve M. dhe G.K. Kjo pasuri, me dëshmi trashëgimie, ka kaluar në emër të shtetasve G., A. dhe E.K. dhe, më pas, me kontratë shitjeje, ka kaluar në emër të shtetasit Xh.I.

<sup>27</sup>Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 17.2.2000.

<sup>28</sup>Shkresë me nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

<sup>29</sup>Shitur apartamenti 2+1 me kontratën nr. \*\*\*, datë 12.11.2004, në vlerën 4,000,000 lekë me pjesë takuese 50%.

<sup>30</sup>Certifikata e pronësisë datë 12.11.2004 për apartamentin me sip. 78.09 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Lagjja \*\*\*, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, Durrës, në pronësi të shtetasve G.K., me pjesë 4/6, dhe shtetasve A. dhe E.K. me pjesë 1/6.

<sup>31</sup>Shkresë me nr. \*\*\* prot., datë 8.1.2020, nga ASHK-ja Durrës, s e depozituar nga subjekti me pyetësin nr. 1.

5.6 Komisioni, me pyetësin nr. 2, ka kërkuar nga subjekti të provojë me dokument ligjor dhurimin e të ardhurave nga shitja e shtëpisë për pjesën takuese të vjehrrës dhe pagesën e tatimit për të ardhurat nga shitja e saj.

5.6.1 Subjekti ka shpjeguar se shitjen e kësaj pasurie e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2005 në shumën totale 4,000,000 lekë. Nuk është formalizuar dhënia e kësaj shume me ndonjë kontratë dhurimi për shkak të marrëdhënies së ngushtë familjare.

5.6.2 Subjekti i rivlerësimit, bashkë me pyetësin nr. 2, ka depozituar edhe deklaratën e datës 23.8.2021 në gjuhën italiane të noterizuar/përkthyer, ku znj. A.K., bashkëshortja e të ndjerit A.K. (kunati i Eda Kaja), deklaroi se bashkëshorti i saj nuk ka marrë asnjë shumë nga shitja e apartamentit në Lagjen \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, Durrës, me kontratën me nr. \*\*\*, datë 12.11.2004, ku edhe pse rezultonte trashëgimtar ligjor i z. M.K., të ardhurat nga shitja ia ka dhuruar vëllait E.K.

5.6.3 Subjekti ka depozituar edhe një shkresë kthim përgjigje të datës 18.8.2021<sup>32</sup>, nga ASHK-ja Durrës, e cila konfirmon nga verifikimet e bëra se për aplikimin nr. \*\*\*, datë 17.11.2004, për kalimin e pronësisë së kontratës nr. \*\*\*, datë 12.11.2004, është paguar tatimi, por nuk konfirmon vlerën e apartamentit mbi të cilin është paguar tatimi.

5.7 Komisioni, nga verifikimet e bëra në sistemin ISP të ASHK-së, ka administruar praktikën e tjetërsimit të apartamentit me sip. 78.9 m<sup>2</sup> me kontratë shitjeje në emër të shtetasit Xh.I. Nga praktika rezultoi e depozituar në ASHK kontrata e shitblerjes me nr. \*\*\*, datë 12.11.2004, me shitës shtetasit G., A. dhe E.K. dhe blerës shtetasit Xh.I. për shitjen e apartamentit me sip. 78.09 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Lagjen \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, Durrës, me çmimin 2,000,000 lekë, çmim i paguar jashtë zyrës noteriale. Në këtë kontratë parashikohet se pala shitëse është e detyruar të paguajë në ZRPP-në Durrës 0.5% të çmimit total të shitjes.

5.7.1 Bashkëngjitur kësaj kontrate është edhe mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 17.11.2004, arkëtuar nga shtetasja G.K. shuma 10,000 lekë me përshkrimin “\*\*\*\*”.

5.8 Subjekti i rivlerësimit, me deklaratën *Vetting* dhe me pyetësin nr. 2, ka depozituar kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 12.11.2004, përpiluar në zyrën e notere A. Sh., me çmim shitjeje të apartamentit në vlerën 4,000,000 lekë, ndërkohë që në ASHK-në Durrës është depozituar kontrata e shitjes nr. \*\*\*, datë 12.11.2004, përpiluar po në zyrën e notere A. Sh., por me çmim shitjeje të apartamentit në vlerën 2,000,000 lekë.

Pra, ekzistojnë dy kontrata shitblerjeje të cilat kanë të njëjtën datë, të njëjtin numër repertori dhe koleksioni, të njëjtat palë, e njëjta notere, por çmimi i shitjes është i ndryshëm.

5.9 Nga verifikimi i veprimeve bankare në “Intesa Sanpaolo Bank”<sup>33</sup> rezultoi se në llogarinë e shtetasit E.K., në datën 17.11.2004, është kredituar shuma 4,200,000 lekë me përshkrimin “derdhje nga z. Xh.I. për shitje shtëpie”. Në datën 17.12.2004, shtetasi E.K. ka tërhequr shumën 4,213,013 lekë duke e mbyllur përfundimisht llogarinë.

5.9.1 Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti nuk kanë deklaruar në DIPP-në e vitit 2004 kontratën e shitjes së apartamentit dhe të ardhurat e përfituara prej tij.

Nga verifikimi i deklaratave periodike rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit si kursime *cash*.

5.10 Në lidhje me burimin e shumës 41,000 euro, të depozituar në llogarinë bankare të bashkëshortit në datën 8.10.2005, subjekti ka shpjeguar se ka si burim depozitat e mbyllura në fund të vitit 2004 (shuma 605,000 lekë – tërhequr nga depozita e bashkëshortit më 17.12.2004

<sup>32</sup>Përgjigjja kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 18.8.2021, e ASHK-së Durrës, depozituar nga subjekti bashkë me pyetësin nr. 2.

<sup>33</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2020, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

dhe shuma 5,000 euro – tërhequr nga depozita e subjektit në datën 23.11.2004) dhe shumën 4,000,000 lekë të përfituar nga shitja e apartamentit me sip. 78.9 m<sup>2</sup>.

5.10.1 Në këto kushte, Komisioni ka marrë në konsideratë në analizën financiare për vitin 2004 si të ardhura të ligjshme nga shitja e apartamentit vetëm pjesën takuese (sipas vërtetimit të pronësisë 1/6) të shumës 2,000,000 lekë<sup>34</sup> (2,000,000 lekë \* 1/6 = 333,333 lekë) dhe për vitin 2005 ka marrë në analizë pjesët takuese të shtetasve G. (4/6) dhe A.K. (1/6), të cilat subjekti i deklaroi si dhurim në DIPP-në e vitit 2005 (2,000,000 lekë \* 5/6 = 1,333,333 lekë).

5.11 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

- subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2004 kontratën e shitjes së apartamentit me vlerë 4,000,000 lekë, si dhe përfitimin e shumës 4,200,000 lekë në llogarinë e bashkëshortit, realizuar nga kjo shitje;
- ka mospërputhje të vlerës së shitjes së apartamentit me sip. 78.9 m<sup>2</sup>, pasi në kontratën e shitjes të depozituar nga subjekti në ILDKPKI dhe Komision, pasqyrohet vlera 4,000,000 lekë, ndërsa në kontratën e shitjes të depozituar në ASHK, me të njëjtat palë, të njëjtët numra repertori dhe koleksioni, e njëjta datë dhe e hartuar nga e njëjta notere është shënuar vlera 2,000,000 lekë në llogarinë bankare dhe bashkëshorti i subjektit ka përfituar shumën 4,200,000 lekë;
- subjektit i është kërkuar të depozitojë kontratën autentike të shitjes së datës 12.11.2004;
- subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2004 si kursime *cash* shumën e përfituar nga shitja e apartamentit;
- janë kryer veprime fiktive dhe ka deklarim të rremë në lidhje me çmimin e shitjes së apartamentit, pasi ka dy kontrata me datë dhe numër repertori dhe koleksioni të njëjtë, por që pasqyrojnë çmime të ndryshme<sup>35</sup>. Duket se ky veprim ka pasur për qëllim shmangien e pagesës së tatimit nga bashkëshorti i subjektit mbi çmimin real të shitjes së apartamentit prej 4,000,000 lekësh, vërtetuar kjo edhe me veprimin bankar në “Intesa Sanpaolo Bank”, ku rezultoi se në llogarinë e shtetasit E.K., në datën 17.11.2004, është kredituar shuma 4,200,000 lekë, me përshkrimin “derdhje nga z. Xh.I. për shitje shtëpie”.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

5.12 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se shitjen e kësaj pasurie e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2005, në shumën totale 4,000,000 lekë, sikundër është nënshkruar në kontratën autentike të shitblerjes së lidhur më 12.11.2004, me palë blerëse z. Xh.I.

5.12.1 Komisioni duhet të marrë në konsideratë si të ardhur të ligjshme vlerën prej 4,000,000 lekësh, të evidentuar në kontratën autentike të shitjes së datës 12.11.2004 (kontratë origjinale e depozituar nga subjekti në prapësime, e cila pasqyron vlerën 4,000,000 lekë), si dhe për faktin se kjo vlerë është deklaruar në DIPP dhe në deklaratën *Vetting* dhe përputhet me transaksionet bankare.

5.12.2 Në lidhje me kontratën e shitblerjes me çmim të ndryshëm, e vënë në dispozicion nga Komisioni, subjekti deklaroi se nuk ka pasur dijeni në lidhje me procedurën e regjistrimit të kësaj kontrate në ZVRPP sepse nuk ka qenë palë në kontratë dhe veprimet kryeshin nga noteri.

5.12.3 Pasi subjekti është vënë në dijeni lidhur me dokumentacionin gjatë hetimit dhe për mandatarëtimin e nënshkruar nga znj. G.K. shpjegoi se këto procedura, për sa mbante mend

<sup>34</sup>Shuma 2,000,000 lekë për të cilën nga shitësit është paguar tatim mbi të ardhurat e përfituara nga shitja.

<sup>35</sup>Kontrata me çmimin 4,000,000 lekë, depozituar nga subjekti dhe kontrata me çmimin 2,000,000 lekë, depozituar në ASHK-në Durrës.

kjo shtetase, janë kryer për efekt të pagimit të tatimit dhe ka paguar aq sa është përcaktuar nga ZVRPP-ja.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

5.13 Komisioni vëren se subjekti në prapësime nuk ka shpjeguar mosdeklarimin e shitjes së apartamentit, ku është përfituar vlera 4,000,000 lekë në vitin 2004, ndërsa kur është pyetur në seancë dëgjimore subjekti ka shpjeguar se shitja ka ndodhur në vitin 2004, por kjo shumë është deklaruar në DIPP-në e vitit 2005, vit në të cilin është përdorur. Gjithashtu, nuk ka shpjeguar diferencën në shumën 200,000 lekë, të kaluar nga blerësi i apartamentit në llogarinë bankare të bashkëshortit.

5.13.1 Komisioni vëren se edhe pse subjekti ka depozituar kontratën autentike me vlerë 4,000,000 lekë, krijohet bindja që për këtë pasuri, nga personi i lidhur me subjektin, bashkëshorti dhe familjarët e tij, është përpiluar edhe kontrata e shitjes me çmimin 2,000,000 lekë me qëllim shmangien e pagimit të tatimit mbi të ardhurat nga shitja. Ky fakt përforcohet nga mandatpagesa e tatimit në shumën 10,000 lekë për vlerën 2,000,000 lekë, nënshkruar nga znj. G.K.

5.13.2 Referuar shumës 4,000,000 lekë edhe pse subjekti nuk ka deklaruar këtë shumë në deklaratën periodike të vitit 2004 as si shitje dhe as si kursim, nga veprimet bankare konfirmohet kalimi dhe tërheqja e saj në datën 17.12.2004. Gjithashtu, nga hetimi nuk ka rezultuar që pas tërheqjes, nga subjekti të jetë përdorur për krijimin e ndonjë pasurie tjetër, përveç apartamentit për të cilin deklaroi se e ka përdorur këtë shumë. Për këtë arsye, Komisioni e ka konsideruar të ardhurën nga shitja e apartamentit si gjendje *cash* në vitin 2004.

5.13.3 Në analizën financiare për vitin 2004, Komisioni, për sa u shpjegua më sipër, ka marrë në konsideratë si të ardhura nga shitja e apartamentit vetëm shumën 2,000,000 lekë mbi të cilën është paguar tatimi mbi të ardhurat.

### **Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në lidhje me shumën e përfituar prej 4,000,000 lekësh, në DIPP, në kundërshtim me pikën 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.**

Subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime fiktive me depozitim në Komision të kontratës së shitjes me vlerë 4,000,000 lekë, ndërkohë që në ASHK rezulton e depozituar kontrata e shitjes me të njëjtat ekstremite me vlerë 2,000,000 lekë, me qëllim shmangien e pagimit të tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga vlera reale e shitjes.

Subjekti ka bërë deklaram të rremë në paraqitjen e të dhënave jo reale të kontratave dhe deklarimeve përpara Komisionit.

### **6. Të ardhura nga shitja e aksioneve të kantinës së pijeve “\*\*\*\*”**

Kjo shitje është kryer sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, në emër të subjektit dhe të bashkëshortit. Pjesa takuese: 50%/secili. Vlera: 100,000 lekë.

6.1 Subjekti në deklaratën *Vetting* ka depozituar deklaratën noteriale datë 10.12.2007<sup>36</sup>, ku shtetasit E. dhe Eda Kaja deklarojnë se secili është aksioner me nga 50 aksione (ku secila përfaqëson 0.015%) të kapitalit të shoqërisë anonime kantina e pijeve “\*\*\*\*” sh.a., Durrës. Këto aksione do t’i shiten z. L.K. në shumën 100,000 lekë, në datën e kësaj deklarate. Kur të nevojitet do të lidhet dhe nënshkruhet kontrata e shitjes së aksioneve pa pasur asnjë pretendim financiar.

6.2 Gjatë hetimit është administruar përgjigja e QKB-së<sup>37</sup> që konfirmon se shtetasit Eda dhe E.K. rezultojnë të kenë qenë aksionerë zotërues me 0.01% të aksioneve në kantinën e pijeve

<sup>36</sup>Deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 10.12.2007.

<sup>37</sup>Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2020, nga QKB-ja.

“\*\*\*\*” sh.a., me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.8.1995, dhe janë larguar nga kjo shoqëri në datën 5.8.2009.

6.3 Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit me pyetësonin nr. 2 për mosdeklarimin e aksioneve prej saj dhe bashkëshorti në DIPP-në e viteve 2003 – 2009.

6.3.1 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar, ndër të tjera, se këto aksione nuk janë deklaruar pasi kanë pasur vlera të vogla dhe nuk janë shpenzuar lekë për blerjen e tyre, pasi janë përfituar nga privatizimi. Lidhur me këto aksione, subjekti deklaroi se i ka deklaruar ato në deklaratën *Vetting* në rubrikën “angazhime dhe veprimtari”, ku ka cilësuar të ardhurat e bashkëshortit në vite si punëtor në kantinën e pijeve “\*\*\*\*” për periudhën 1994 – prill 2002 (paga + aksione), në vlerën 1,003,028 lekë.

6.4 Komisioni vëren se bashkëshorti i subjektit ka përfituar aksione nga privatizimi i ndërmarrjes si ish-punonjës. Në datën 10.12.2007, së bashku me subjektin kanë përfituar nga shitja e tyre vlerën 100,000 lekë. Referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, për “Tatimin mbi të ardhurat” subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë depozituar pagesë të tatimit për të ardhurat e realizuara nga ky transaksion në vlerën 100,000 lekë. Këto të ardhura nuk konsiderohen të ardhura të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare.

6.4.1 Komisioni ka hetuar për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me kantinën e pijeve “\*\*\*\*” dhe ortakun L.K. dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë<sup>38</sup>.

6.5 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka përfituar aksione (në vitet 1995 – 5.8.2009) në kantinën e pijeve “\*\*\*\*” sh. a., gjatë kohës së ushtrimit të detyrës së gjyqtarit. Zotërimi i aksioneve në një shoqëri aksionare, bazuar në ligjin nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, përbën papajtueshmëri me detyrën e gjyqtarit sipas parashikimit të nenit 22 të këtij ligji<sup>39</sup>.

6.6 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

- subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti nuk kanë deklaruar në deklaratat periodike të viteve 2003 – 2009 aksionet që kanë pasur në kantinën e pijeve “\*\*\*\*”, Durrës, ku duket se është bërë me qëllim fshehjen e tyre;
- subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e aksioneve në shumën 100,000 lekë për përfshirjen e tyre në analizën financiare;
- subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë me detyrën e gjyqtarit lidhur me zotërimin e aksioneve në shoqërinë aksionare “\*\*\*\*”.

Për këto konstatime subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

6.7 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se aksionet i ka deklaruar në ILDKPKI sipas procesverbalit të vitit 2010 dhe në deklaratën *Vetting*. Këto aksione kanë pasur vlerë të papërfillshme dhe janë zotëruar nga bashkëshorti i subjektit, si dhe janë përfituar për shkak të ligjit. Këto aksione kanë qenë gjithmonë pasive, nuk është shpërndarë dividend dhe nuk kanë pasur vendimmarrje.

<sup>38</sup>Shkresë me nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, ku janë bashkëngjitur vendimet nr. \*\*\*, datë 24.1.2014, gjykuar nga gjyqtari V. S. dhe nr. \*\*\*, datë 29.1.2021, gjykuar nga gjyqtari R. B., por jo nga subjekti Eda Kaja.

<sup>39</sup>Neni 22 përcakton: “Gjyqtari nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër shtetërore, private ose politike”.

6.7.1 Subjekti deklaron se shitja e aksioneve të shoqërisë prej saj dhe bashkëshortit vërteton dukshëm, pikërisht, mënjanimin apo parandalimin e konfliktit të interesit.

6.7.2 Në seancë dëgjimore, përfaqësuesja e subjektit ka shpjeguar se nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit deri në momentin e shitjes së aksioneve, ka qenë një periudhë shumë e shkurtër kohe, pra gjendja e konfliktit të interesit do të ishte e papërfillshme.

6.7.3 Subjekti, në seancën dëgjimore, ka depozituar dokumentin “kthim përgjigje” të datës 9.11.2021 nga kantina e pijeve “\*\*\*\*” sh.a., ku në kuadër të privatizimit të shoqërive shtetërore subjekti dhe bashkëshorti kanë përfituar nga 50 aksione/secili, pa paguar vlera monetare.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

6.8 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit, në prapësime dhe në seancë dëgjimore, nuk ka shpjeguar mosdeklarimin e aksioneve në DIPP-të e viteve 2003 – 2009, si dhe nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me mospagimin e tatimit mbi të ardhurat nga shitja. Ndërkohë në lidhje me papajtueshmërinë e funksionit të gjyqtarit (gjendjen e konfliktit të interesit) subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse dhe Komisioni vlerëson së papajtueshmëria ka qenë prezente dhe se subjekti nuk duhet të kishte qenë aksionere në kantinën e pijeve “\*\*\*\*” sh.a.

### **Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm të zotërimit të aksioneve në deklaratat periodike në kundërshtim me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.**

Subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e papajtueshmërisë së funksionit të gjyqtarit në zotërimin e aksioneve të kantinës së pijeve “\*\*\*\*” në kundërshtim me ligjin nr. 9877, datë 18.2.2008 (i ndryshuar).

### **7. Kredi bankare në NBG, dega Durrës, në datën 22.4.2008**

Kjo kredi është marrë me qëllim blerjen e apartamentit të përbashkët të regjistruar në emër të bashkëshortit. Nuk është përcaktuar vlera e kredisë dhe mbetur pa shlyer shuma 3,128.21 euro.

7.1 Në DIPP-në e vitit 2008 subjekti deklaron: *“Në datën 22.4.2008 është disbursuar një kredi me shumën 30,000 euro. Në datën 22.11.2008 është bërë shlyerja e pjeshme e kredisë në shumën 25,000 euro me fondet e siguruara nga shitja e dyqanit”.*

7.2 Subjekti, bashkë me deklaratën *Vetting* ka depozituar kontratën e kredisë<sup>40</sup>, datë 17.4.2008, me kredihënës NBG dhe kredimarrësit Eda dhe E.K. për kredinë në shumën 30,000 euro, me qëllim blerjen e apartamentit me sip. 55 m<sup>2</sup>, në Lagjen \*\*\*, Plazh, Durrës, me afat shlyerje 20 vjet.

7.2.1 Gjithashtu, është depozituar kontrata e hipotekës<sup>41</sup>, datë 17.4.2008, me hipotekues shtetasit Eda dhe E.K., si dhe vërtetimin, datë 18.10.2016, të NBG-së, sipas të cilit më 21.11.2008, klienti ka bërë shlyerje të pjeshme të kredisë në shumën 25,000 euro, me fonde nga shitja e një dyqani. Teprica e kredisë në datën 18.10.2016 është në vlerën 3,128.21 euro.

7.3 “ABI Bank”<sup>42</sup> (ish-NBG-ja blerë nga “ABI Bank”) konfirmon marrjen e kredisë në shumën 30,000 euro, e disbursuar në datën 22.4.2008. Në datën 23.4.2008 është transferuar për llogari të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. shuma 29,322.58 euro, duke konfirmuar qëllimin e marrjes së kredisë të deklaruar nga subjekti.

7.4 Lidhur me burimin e shumës 25,000 euro, që ka shërbyer për shlyerjen e pjeshme të kredisë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat nga shitja e dyqanit për ½ pjesë në

<sup>40</sup>Kontrata e kredisë nr. \*\*\*, datë 17.4.2008.

<sup>41</sup>Kontrata hipotekore nr. \*\*\*, datë 17.4.2008.

<sup>42</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2020, nga “ABI Bank”.

shumën 23,000 euro, sipas kontratës premtim-shitje nr. \*\*\*, datë 12.11.2008, për çmimin 46,000 euro<sup>43</sup> dhe kursimet familjare (në vlerën 2,000 euro).

7.5 Referuar kontratës përfundimtare të shitjes datë 31.5.2012<sup>44</sup>, për shumën 2,659,959 lekë, kontratë mbi të cilën është bërë kalimi i pronësisë dhe është paguar tatimi, të ardhurat e ligjshme të përfituara nga subjekti i rivlerësimit sipas pjesës takuese (1/3), të cilat janë përdorur si burim për shlyerjen e kredisë, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës janë në shumën 886,653 lekë (1/3 \* 2,659,959 lekë), shumë që rezulton se është më e vogël se shuma 2,834,520 lekë (vlera 23,000 euro e konvertuar me kursin e datës 21.11.2008) me të cilën është shlyer kredia.

7.6 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh të ligjshme për shlyerjen e kredisë, pasi të ardhurat e përfituara nga shitja e dyqanit, për të cilat është paguar tatim (vlera 886,653 lekë), janë në vlerë më të vogël se shuma e paguar për shlyerjen e kredisë (vlera 2,834,520 lekë).

Për këto konstatime subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

7.7 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se Komisioni duhet të marrë në konsideratë shumën e përfituar nga shitja e dyqanit sipas kontratës së premtim-shitjes në vlerën 23,000 euro.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

7.8 Komisioni vëren se pretendimi i subjektit për marrjen në konsideratë të shumës 23,000 euro për shlyerjen e kredisë nuk qëndron sepse, ashtu si është shpjeguar më lart, subjekti nuk ka provuar me dokumentacion pagesën e tatimit për të ardhurat e pretenduara të realizuara nga shitja në shumën 23,000 euro, për pjesën e saj takuese.

7.9 Komisioni vlerëson se edhe pas prapësimeve dhe shpjegimeve të dhëna në seancën dëgjimore subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës për mungesën e burimeve të ligjshme për shlyerjen e kredisë sepse të ardhurat e përfituara nga shitja e dyqanit në shumën 23,000 euro në analizën financiare janë llogaritur në shumën 0 (zero) lekë, pasi për këtë shumë nuk është paguar tatim – konfirmuar nga subjekti. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për shlyerjen e kredisë në shumën 2,834,520 lekë.

**Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 2,834,520 lekë, për shlyerjen e kredisë me të ardhurat e përfituara nga shitja e dyqanit.**

### **❖ Personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti E.K.**

**8. Automjet, tip “Mercedes-Benz C-Class 203”, viti i prodhimit 2001, me targa \*\*\*, blerë në vitin 2009**

Vlera: 5,000 euro. Pjesa takuese: 100%. Burim krijimi: të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit të mëparshëm.

<sup>43</sup>Pagesat sipas kontratës: kësti i parë në shumën 35,677 euro me nënshkrimin e kontratës; kësti i dytë në shumën 4,323 euro në datën 12.12.2008 dhe kësti i tretë në shumën 6,000 euro brenda datës 30.4.2009.

<sup>44</sup>Kontratë shitjeje me nr. \*\*\*, datë 31.5.2012, me shitës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetasit Eda Kaja dhe R.H. dhe blerës I.Ll.

8.1 Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2009 si blerje automjeti nga bashkëshorti i saj, në Gjermani, në shumën 5,000 euro + 350,000 lekë dogana.

8.2 Nga dokumentacioni i përcjellë nga DPSHTRR-ja<sup>45</sup> konfirmohet se automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\* është blerë nga shtetasi E.K., në Gjermani, në datën 5.10.2009, me çmimin 5,000 euro. Po kështu, sipas dokumentit doganor datë 11.10.2009, shtetasi E.K. ka paguar doganën në vlerën 345,022 lekë (vlera e automjetit 5,000 euro, llogaritur me kursin ditor 134,51 lekë/euro). Në total, automjeti ka kushtuar 5,000 euro + 2,565 euro (345,022:134.51) = 7,565 euro. Më pas, automjeti me kontratën e datës 26.11.2018<sup>46</sup> i është shitur blerësit A.Gj. me çmimin 3,250 euro.

8.3 *Në lidhje me analizën e automjetit tip “Mercedes-Benz 250 D”, me targa \*\*\**

Të ardhurat e përfituara nga shitja e tij kanë shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz W 203”, me targa \*\*\*. Vlera: 5,000 euro.

8.3.1 Në DIPP-në e vitit 2004 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz 250 D”, të vitit 1992, ndërsa në DIPP-në e vitit 2009 ka deklaruar shitjen e tij në shumën 1,000,000 lekë.

8.3.2 Subjekti, bashkë me deklaratën *Vetting* ka depozituar kontratën e shitblerjes së automjetit me targa \*\*\*, datë 15.7.2009<sup>47</sup>, me shitës E.K. dhe blerës Y.S. për çmimin 1,000,000 lekë, si dhe ka depozituar edhe dokumentin doganor të datës 24.8.2004, ku për këtë automjet është paguar taksa doganore në shumën 193,380 lekë.

8.3.3 DPSHTRR-ja<sup>48</sup> konfirmon se automjeti tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 1992, është blerë nga shtetasi E.K. në datën 12.8.2004, në Gjermani, për vlerën 1,300 euro dhe paguar taksa doganore më 24.8.2004, në shumën 193,380 lekë. Automjeti, në total, ka kushtuar 193,380 lekë + 164,762 lekë (1,300 euro \* 125,17 lekë) = 358,342 lekë.

Me kontratën e datës 15.7.2009<sup>49</sup> shtetasi E.K. ia shet (pas 5 vjetësh) këtë automjet blerësit Y.S., me çmimin 1,000,000 lekë.

8.3.4 Për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga diferenca e çmimit të blerjes me atë të shitjes, subjekti, në pyetësin nr. 2, ka shpjeguar, ndër të tjera, se ky automjet ka pasur nevojë për riparime dhe shërbime, të cilat janë bërë nga bashkëshorti kur është sjellë në Shqipëri (pasi ka njohuri mbi automjetet).

8.3.5 Për tatimin mbi të ardhurat për diferencën e çmimit të blerjes me atë të shitjes, subjekti shpjegon se bashkëshorti nuk ka pasur dijeni, pasi ky fakt nuk ka qenë i shprehur në mënyrë eksplicite në ligj dhe kontratë. Po kështu, subjekti deklaroi që nuk ka pasur dijeni për pagesën e një tatimi të tillë. Gjithashtu, edhe vetë kuadri ligjor nuk parashikon penalitete mbi pagimin e tatimit mbi të ardhurat me vonesë dhe nuk e pengon tatimpaguesin që këto të ardhura t'i shlyejë edhe në një moment të mëvonshëm dhe, për këtë arsye, subjekti ka depozituar mandatpagesën e kryer për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të tri automjeteve të tjetësuara në shumën totale 222,291 lekë, datë 30.3.2021, me përshkrimin “Eda Kaja pagesë tatim i mbajtur në burim për automjetet me targa \*\*\*, \*\*\* dhe \*\*\*”.

8.3.6 Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit me targa \*\*\*, në vlerën 1,000,000 lekë, në datën 15.7.2009, të cilat janë përdorur si burim për blerjen e mjetit me targë

<sup>45</sup>Shkresë me nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2020, nga DPSHTRR-ja.

<sup>46</sup>Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 26.11.2018.

<sup>47</sup>Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 15.7.2009.

<sup>48</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2021, nga DPSHTRR-ja.

<sup>49</sup>Kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 15.7.2009.



\*\*\* në vlerën 1,030,872 lekë <sup>50</sup> në datë 11.10.2009, Komisioni konstatoi se tatimi për të ardhurat e përfituara nga diferenca e çmimit është paguar në datën 30.8.2021, pas nisjes së procesit të rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Detyrimi tatimor lidhur me të ardhurën e përfituar nga diferenca e çmimit të shitjes me atë të blerjes nuk është paguar i plotë, pasi shuma e paguar nuk përfshin interesat dhe kamatëvonesat e llogaritura nga momenti i lindjes së detyrimit deri në momentin e pagesës. Gjithashtu, subjekti nuk vërtetoi me dokumente ndonjë riparim teknik/vizual që mund t'i ishte bërë automjetit dhe vlera përkatëse e shpenzimeve të kryera.

8.3.6.1 Komisioni, referuar edhe praktikës së ndjekur nga Kolegji, ka marrë në konsideratë në analizën financiare të ardhurat nga shitja e automjetit deri në nivelin e çmimit të blerjes, pa përfshirë fitimin e realizuar nga shitja, pasi në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës nuk konsiderohen të ardhura të ligjshme.

Në këto kushte, si të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit me targa \*\*\*, në vlerën 1,030,872 lekë do të konsiderohet vetëm vlera 358,142 lekë e çmimit të shitjes. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 672,730 lekë. (1,030,872 - 358,142).

8.3.7 Komisioni, me pyetësorin nr. 2, ka kërkuar nga subjekti të deklarojë burimin e krijimit të automjetit tip “Mercedes-Benz 250 D”, me targa \*\*\*, duke e provuar me dokument ligjor.

8.3.7.1 Subjekti ka shpjeguar se burimi i ligjshëm i blerjes së automjetit me targa \*\*\*, në vlerën 1300 euro + 193,580 lekë, janë të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit me targa \*\*\*, datë 22.9.2004, paratë e të cilit bashkëshortit i janë dhënë paraprakisht nga blerësi.

8.3.7.2 Subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes datë 19.11.2003<sup>51</sup>, me shitës B.Xh. dhe blerës E.K., me çmimin 500,000 lekë, si dhe kontratën e shitjes së këtij automjeti datë 22.9.2004<sup>52</sup>, me shitës E.K. dhe blerës K.A., me çmimin 250,000 lekë.

8.4 *Në lidhje me analizën e burimit të krijimit të automjetit tip “Mercedes-Benz 250 D”, me targa \*\*\**

Ky automjet është blerë me të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz 200 D”, viti i prodhimit 1986, me targa \*\*\*.

8.4.1 Nga DPSHTRR-ja<sup>53</sup> konfirmohet se me kontratën e datës 19.11.2003<sup>54</sup> shtetasi B.Xh. ia shet automjetin me targa \*\*\* shtetasit E.K., në çmimin 500,000 lekë. Nga dokumenti doganor i datës 15.11.2003 rezulton se shtetasi B.Xh. ka paguar shumën 164,497 lekë.

Më pas, me kontratën e datës 22.9.2004, shtetasi E.K. ia shet automjetin me targa \*\*\* shtetasit K.A., me çmimin 250,000 lekë, jashtë zyrës noteriale.

8.4.2 Lidhur me burimin e krijimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni konstaton se të ardhurat nga shitja e automjetit me targa \*\*\*, në shumën 250,000 lekë, janë përfituar në datën 22.9.2004, pas blerjes së automjetit me targa \*\*\*, në datën 24.8.2004 dhe, si të tilla, nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e automjetit. Marrja e të ardhurave nga shitja, paraprakisht, nga blerësi mbetet në kuadër deklarativ.

8.4.2.1 Pavarësisht kësaj, edhe nëse Komisioni merr në konsideratë deklarimin e subjektit, duket se këto të ardhura nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar vlerën e plotë të çmimit prej

<sup>50</sup>Vlera totale e automjetit është 1,030,872 lekë, ku çmimi i blerjes 5,000 euro, llogaritur me kursin 137.17 lekë/euro është në vlerën 685,850 lekë dhe 345,022 lekë është detyrimi doganor.

<sup>51</sup>Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 19.11.2003.

<sup>52</sup>Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 22.9.2004.

<sup>53</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2021, nga DPSHTRR-ja.

<sup>54</sup>Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 19.11.2003.

358,342 lekësh, pasi rezulton me mungesë burimesh në shumën 108,342 lekë (358,342-250,000).

8.4.3 Komisioni kreu analizën financiare të subjektit në datën e blerjes 24.8.2004, të automjetit me targa \*\*\*, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 788,508 lekë për përballimin e shpenzimeve dhe blerjen e automjetit me targa \*\*\*, në vlerën 358,142 lekë, në datën 24.8.2004.

<b>Përshkrimi</b>	<b>24.8.2004</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>757,221</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	507,221
Të ardhura nga shitja e automjetit me targa ***	250,000
<b>Detyrime</b>	<b>0</b>
<b>Shpenzime</b>	<b>363,065</b>
Shpenzime jetike	250,304
Shpenzime udhëtimi	112,761
<b>Pasuri</b>	<b>1,182,663</b>
Kursime (shtesa/pakësime likuiditeti)	824,521
Automjet tip “Mercedes-Benz 250 D”, vit prodhimi 1992, me targa ***	358,142
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri</b>	<b>-788,508</b>

8.4.4 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shtetasit A.Gj., Y.S., V.Xh. dhe K.A. dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë<sup>55</sup>.

8.5 Komisioni, gjatë hetimit administrativ në lidhje me mjetet e analizuar më lart, ka konstatuar se:

- subjekti i rivlerësimit ka paguar tatimin mbi të ardhurat për diferencën e çmimit të blerjes me atë të shitjes datë 30.8.2021, me vonesë, vetëm për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar *Vetting*, si dhe nuk ka paguar kamatëvonesat dhe gjobat nga momenti i lindjes së detyrimit deri në kryerjen e pagesës;
- subjekti nuk ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*, në DIPP-në e vitit 2004 (burim i blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”);
- subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh për blerjen e automjetit me targa \*\*\*, në shumën 108,142 lekë;
- subjekti i rivlerësimit për blerjen e automjetit me targa \*\*\* ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 672,730 lekë;
- subjekti nuk ka deklaruar shitjen e automjetit me targa \*\*\*, në DIPP-në e vitit 2004 (burim i blerjes së automjetit me targa \*\*\*);
- subjekti nuk ka deklaruar blerjen e automjetit me targa \*\*\*, në DIPP-në e vitit 2004 (burim i blerjes së automjetit me targa \*\*\*)).

Për këto konstatime, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

8.6 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se të ardhurat nga shitja e automjetit me targa \*\*\* (burim për blerjen e automjetit me targa \*\*\*, më

<sup>55</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Vendimet: nr. \*\*\*, datë 29.10.2004, dhënë nga gjyqtari M. M.; nr. \*\*\*, datë 26.11.2012, dhënë nga gjyqtari A. L.; nr. \*\*\*, datë 14.7.2010, dhënë nga subjekti M. K.; nr. \*\*\*, datë 9.11.2009, dhënë nga gjyqtari E. S.; nr. \*\*\*, datë 3.3.1992, dhënë nga gjyqtari V. S.; nr. \*\*\*, datë 25.2.2004, dhënë nga gjyqtari M. Xh.; nr. \*\*\*, datë 26.4.2001, dhënë nga gjyqtari N. T.

24.8.2004) janë përfituar në muajin korrik, përpara lidhjes së kontratës më 22.9.2004 dhe, për këtë, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale të datës 29.10.2021, të blerësit K.A., i cili konfirmon këtë deklaram.

8.6.1 Në lidhje me mosdeklarimin e blerjes së automjetit me targa \*\*\*, në vitin 2004, subjekti ka shpjeguar se nuk e ka deklaruar atë, pasi në vitin 2003 kishte deklaruar zotërimin e një automjeti tjetër dhe në vitin 2004 kishte ndryshuar vetëm llojin e automjetit. Këto kanë qenë pasaktësi të paqëllimshme dhe mungesa e eksperiencës në plotësimin e deklaratave të para.

8.6.2 Subjekti nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me mungesën e burimeve për blerjen e automjetit me targa \*\*\*, gjithashtu nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me mosdeklarimin e shitjes së automjetit me targa \*\*\*, në DIPP-në e vitit 2004.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

8.7 Komisioni vëren se në lidhje me pagesën e tatimit për diferencën e çmimit nga shitja e automjeteve, subjekti nuk ka dhënë shpjegime në prapësime, por i ka shpjeguar në pyetësorë. Pagimi i tatimit mbi të ardhurat për diferencën e çmimit të blerjes me atë të shitjes nuk është bërë në kohën e kryerjes së veprimit të shitblerjes, por është bërë për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Për këtë arsye Komisioni do të përfshijë në analizë financiare si të ardhur vetëm çmimin e blerjes së këtij automjeti.

8.8 Subjekti ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me kohën e përfitimit të të ardhurave nga shitja e automjetit me targa \*\*\*, të provuara këto edhe me deklaratën noteriale të blerësit K. A., i cili konfirmon këtë deklaram.

8.8.1 Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me mosdeklarimin e blerjes së automjetit në vitin 2004 nuk qëndrojnë. Subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për të deklaruar çdo ndryshim në pasuritë e tij, pavarësisht llojit dhe vlerës.

### **Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me automjetet në deklaratat periodike vjetore në kundërshtim me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.**

Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit me targa \*\*\*, në shumën 108,142 lekë dhe blerjen e automjetit me targa \*\*\*, në shumën 672,730 lekë në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

### **9. Apartament<sup>56</sup> me sip. 55 m<sup>2</sup>, në emër të shtetasit E.K.**

Kjo pasuri ka adresën: ap. \*\*\*, k. \*\*\*, Lagja \*\*\*, Shkëmbi i Kavajës, Plazh, Durrës, i blerë me kontratën e shitblerjes datë 14.4.2008<sup>57</sup>. Vlera: 3,690,000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: (a) të ardhurat familjare; (b) kredi në NBG, datë 18.10.2016.

9.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “Një pjesë e kësaj kredie është shlyer me lekët e marra sipas kontratës së shitjes (premtim-shitje) së një dyqani, një pjesë të të cilit bashkëshortja ime e ka përfituar si bashkëpronare e truallit mbi bazën e kontratës së shkëmbimit datë 16.4.2009, me palën shkëmbyese me shoqërinë e ndërtimit ‘\*\*\*’ sh.p.k. Shitur me kontratën nr. \*\*\*, datë 31.5.2012, në vlerën 2,659,959 lekë”.

9.2 Subjekti e ka deklaruar këtë apartament për herë të parë në DIPP-në e vitit 2008: “Blerë apartament 1+1, ndodhur në Lagjen \*\*\*, Plazh, regjistruar me nr. \*\*\*, datë 15.4.2008, në ZVRPP-në Durrës, në shumën 41,600 euro. Pjesa takuese: 50%”.

<sup>56</sup>Apartamenti me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, nr. hipotekor \*\*\*.

<sup>57</sup>Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 14.4.2008.

9.3 Subjekti ka depozituar dokumentacionin ligjor, nga ku rezulton se ky apartament është përfituar nga kontrata e shitblerjes datë 14.4.2008<sup>58</sup> me shitës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe blerës E.K. për apartamentin me nr. \*\*\*, k. \*\*\*, shk. \*\*\*, me sip. 55 m<sup>2</sup> me vendndodhje në Lagjen 13, Plazh, Durrës, me çmimin 3,690,000 lekë. Pagesa është bërë e gjitha *cash*, jashtë kësaj zyre noteriale.

Subjekti ka depozituar edhe vërtetimin hipotekor, datë 15.4.2008, për apartamentin me sip. 55 m<sup>2</sup>, në emër të shtetasit E.K.

9.4 Është administruar përgjigjja e ASHK-së Durrës<sup>59</sup>, e cila ka bashkëngjitur kartelën e pasurisë, ku konfirmohet apartamenti me sip. 55 m<sup>2</sup>, në pronësi të shtetasit E.K.

9.5 Komisioni, me pyetësin nr. 2, ka kërkuar nga subjekti të shpjegojë mospërputhjen në çmimin e apartamentit, deklaruar 41,600 euro në DIPP-në e vitit 2008, ndërsa në deklaratën *Vetting* dhe në kontratën e shitjes datë 14.4.2008 pasqyrohet shuma 3,690,000 lekë.

Subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se vlera 41,600 euro përfaqëson shpenzimet e kryera për këtë apartament për ndryshime në strukturë dhe mobilim. Çmimi real është 3,690,000 lekë. Këtë pasaktësi në deklaramin subjekti shpjegon se e ka sqaruar në ILDKPKI në vitin 2010 dhe mobilimi i shtëpisë është përmbyllur brenda viteve 2008 – 2010.

9.6 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe administratorit/ortakut O.U. dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë<sup>60</sup>.

#### **9.7 Analizë financiare lidhur me burimin e krijimit të këtij apartamenti**

Burimet e krijimit për këtë pasuri janë: (a) të ardhurat familjare; dhe (b) kredi në NBG.

##### *a) Në lidhje me të ardhurat familjare*

9.7.1 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* shumën e të ardhurave familjare të përdorura për apartamentin me sip. 55 m<sup>2</sup>.

9.7.2 Referuar vlerës 41,600 euro, të deklaruar në DIPP-në e vitit 2008, vlera totale e apartamentit rezulton të jetë 5,124,392 lekë (konvertuar me 123.1825 lekë/euro, kursi i vitit 2008). Shuma prej 3,590,843 lekësh, paguar me bankë ka si burim kredinë në NBG, ndërsa diferenca e vlerës prej 1,434,392 lekësh mbetet të ketë si burim të ardhurat familjare. Subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 kursime *cash* dhe, në këto kushte, të ardhurat familjare të përdorura për apartamentin janë të ardhurat e vitit 2008. Nga analiza financiare e vitit 2008 duket se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme për kryerjen e këtij investimi duke rezultuar me balancë negative<sup>61</sup>.

9.7.3 Në procesverbalin e datës 20.10.2010, në ILDKPKI, kur është pyetur për pamundësinë financiare për blerjen e apartamentit në vitin 2008, subjekti ka deklaruar se: “*Në deklaratën e vitit 2008 kam deklaruar blerjen e apartamentit në Plazh, Durrës, për të cilin kam përdorur një kredi të marrë në shumën 30,000 euro, si dhe gjendjen cash rreth 1,000,000 lekë të mbetur nga viti i mëparshëm 2007. Problemi i mosjustifikimit ka dalë pasi unë nuk kam plotësuar saktë deklaratën e vitit 2007, duke mos deklaruar gjendjen cash. Kujtoj se të ardhurat familjare për*

<sup>58</sup>Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 14.4.2008.

<sup>59</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.8.2021, nga ASHK-ja Durrës.

<sup>60</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Vendimet: nr. \*\*\*, datë 11.3.2019 me palë shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., gjykuar nga gjyqtari Sh. P.; nr. \*\*\*, datë 27.12.2018, me palë shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., gjykuar nga gjyqtari M. K.; nr. \*\*\*, datë 14.1.2008, me palë shoqëria “\*\*\*\*” sh.p., gjykuar nga gjyqtari M. A.; nr. \*\*\*, datë 14.5.2013, me palë shoqëria “\*\*\*\*”, e gjykuar nga gjyqtarët J. Q., M. K. dhe P. Ç.

<sup>61</sup>Shihni analizën financiare të viteve 2003 – 2016.

vitin 2007 kanë qenë rreth 2,400,000 lekë, nga të cilat përveç shpenzimeve për konsum familjar, kam shlyer këste kredie gjithsej 1,050 euro dhe kam kursyer 1,000,000 lekë”.

b) Në lidhje me kredinë në shumën 30,000 euro, në NBG

9.7.4 “ABI Bank”<sup>62</sup> konfirmon marrjen e kredisë në shumën 30,000 euro, e disbursuar në datën 22.4.2008, po në shumën 30,000 euro.

Në datën 23.4.2008 është transferuar për llogari të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. shuma 29,322.58 euro (vlera e konvertuar 3,590,843 lekë)<sup>63</sup> duke konfirmuar qëllimin e marrjes së kredisë.

9.8 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

- ka mospërputhje deklarimi lidhur me vlerën e apartamentit me sip. 55 m<sup>2</sup>, në Plazh, Durrës, për arsye se në DIPP-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar apartamentin me vlerën 41,600 euro, ndërsa në deklaratën *Vetting* dhe në kontratën e shitjes datë 14.4.2008 përcaktohet vlera e apartamentit 3,690,000 lekë;
- nuk janë provuar me dokument ligjor punimet e kryera për përmirësimin e apartamentit, si dhe të mobilimit të tij për të justifikuar diferencën e çmimit 3,690,000 lekë me 41,600 euro;
- subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2008 – 2010 shpenzimet e kryera për përmirësimin e apartamentit të deklaruar prej tij në pyetësin nr. 2;
- subjekti i rivlerësimit nuk ka burime të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në vitin 2008, pasi me të ardhurat familjare të përfituara në po këtë vit nuk mund të përballojë shpenzimet dhe të paguajë për apartamentin shumën 1,434,392 lekë.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

9.9 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se vlera e apartamentit, pa përfshirë mobilimin është 3,690,000 lekë dhe diferenca përbën shpenzimet e mobilimit, të cilat nuk janë kryer të gjitha në vitin 2008. Këto shpenzime nuk janë deklaruar në DIPP-të e viteve 2008 – 2010 sepse detyrimi për deklarim të shpenzimeve sipas ligjit nr. 9049, i vitit 2003, fillon në vitin 2012.

9.9.1 Në lidhje me mundësinë financiare për blerjen e apartamentit dhe përballimin e shpenzimeve në vitin 2008, subjekti ka shpjeguar se Komisioni duhet të marrë në konsideratë gjendjen e likuiditeteve në fillim të vitit 2008 (të mbartura nga viti 2003), të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit, të ardhurat nga shitja e dyqanit në shumën 23,000 euro, si dhe shpenzimet e mobilimit të kryera në vitet 2008 – 2010.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

9.10 Komisioni vëren se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me mosdeklarimin e shpenzimeve për mobilim në DIPP-të e viteve 2008 – 2010 dhe ka marrë në konsideratë vlerën e apartamentit sipas kontratës së shitjes dhe shpenzimet e mobilimit sipas shpjegimeve të subjektit, si dhe ka bërë pasqyrimin e tyre në analizën financiare të rishikuar.

9.10.1 Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për vitin 2008, për të cilën subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka përdorur gjendje *cash* të mbartur nga viti 2003, Komisioni vëren se subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në deklaratimet periodike ndër vite.

<sup>62</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2020, nga “ABI Bank”.

<sup>63</sup>Konvertuar me 122.46 lekë/euro, kursi i datës 23.4.2008, sipas Bankës së Shqipërisë.

9.10.2 Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar përfitimin e të ardhurave nga aktiviteti i bashkëshortit, si dhe të ardhurat në shumën 23,000 euro nga shitja e dyqanit, sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

**Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka burime të mjaftueshme, pasi me të ardhurat familjare të përfituara në vitin 2008 nuk mund të përballojë shpenzimet dhe të paguajë për mobilimin e apartamentit në shumën 1,059,400 lekë.**

#### 10. Të ardhura në vlerën 10,002,316 lekë, nga bashkëshorti i subjektit/E.K.

Këto të ardhura janë realizuar, pasi z. E.K. ka qenë ortak i vetëm i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën 3.7.2006 – 21.12.2009 (fitime nga të ardhurat e shoqërisë sipas shkresës së datës 25.10.2016, me nr. \*\*\* prot. dhe nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2016).

10.1 Në DIPP-në e vitit 2006, bashkëshorti i subjektit E.K. ka deklaruar: “Autoshkolla ‘\*\*\*’, blerë nga znj. M. Ç., me vlerë 100,000 lekë”.

10.2 Subjekti, në deklaratat periodike, ka deklaruar sipas tabelës vijuese.

Viti	Xhiro vjetore/lekë	Fitimi/lekë	Tatimi i paguar	Paga e deklaruar/lekë
2007	3,200,000	1,400,000		
2008		1,207,730	120,730	
2009	2,415,000	479,504		50,000
2010				25,000
2011				25,000

10.3 Në DIPP-në e vitit 2010 subjekti ka deklaruar: “Shitje 100% të aksioneve të autoshkollës ‘\*\*\*’ shtetases M.Ç., në shumën 100,000 lekë”.

10.4 Komisioni ka administruar përgjigjen e DRT-së Durrës<sup>64</sup>, e cila konfirmon se shoqëria “\*\*\*\*” (\*\*\*), me NIPT \*\*\*, ka të dhëna tatimore si vijon:

- viti 2005: të ardhurat 3,601,693 lekë; fitimi/humbja – nuk ka informacion; tatimfitimi i thjeshtuar në vlerën 102,130 lekë;
- viti 2006: të ardhurat 2,967,133 lekë; fitimi/humbja –nuk ka informacion; tatimfitimi i thjeshtuar në vlerën 44,507 lekë;
- viti 2007: të dhënat në bashki – nuk ka informacion; fitimi/humbja – nuk ka informacion; tatimfitimi i thjeshtuar – s’ka informacion;
- viti 2008: të ardhurat 4,305,000 lekë; fitimi/humbja në vlerën 566,872 lekë; tatimfitimi i thjeshtuar në vlerën 56,687 lekë;
- viti 2009: të ardhurat 2,415,000 lekë; fitimi/humbja në vlerën 532,782 lekë; tatimfitimi i thjeshtuar në vlerën 53,278 lekë.

Gjithashtu, DRT-ja Durrës konfirmon se nuk rezulton dividend. Për pagesat e bëra rezultojnë këto të dhëna: kontribute shoqërore në vlerën 1,354,083 lekë; kontribute shëndetësore në vlerën 25,519 lekë dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi në vlerën 251,712 lekë. Nga verifikimi në zyrën e arkivit rezulton se nuk disponohen të dhëna për pasqyrat financiare të periudhës 2005 – 2009.

10.5 Subjekti ka depozituar, gjithashtu, gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar *Vetting*, vërtetimin nga Bashkia Durrës<sup>65</sup>, i cili vërteton që shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën 2007 - 2008, është taksuar me taksë biznesi i vogël për nivel xhiroje 2,000,001 – 3,000,000 lekë.

<sup>64</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2016, nga DRT-ja Durrës.

<sup>65</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2016, nga Bashkia Durrës.

10.6 Komisioni ka administruar përgjigjen e Bashkisë Durrës<sup>66</sup>, ku në dokumentacionin bashkëngjitur rezulton deklarata parashikuese e qarkullimit vjetor për vitin ushtrimor 2008, kur për personin fizik “\*\*\*\*”, me NIPT \*\*\*, rezulton: “*Qarkullim vjetor i parashikuar në lekë 3,000,000 lekë dhe qarkullim faktik për vitin 2007, në shumën 3,000,000 lekë*”.

10.7 Subjekti, në pyetësonin nr. 1, ka deklaruar fitimet/humbjet për deklarimet periodike sipas tabelës vijuese.

Periudha/viti	2005	2006	2007	2008	2009
Fitimi/humbja	3,449,563	2,626,469	2,659,363	510,185	-

10.8 Subjekti, në ILDKPKI<sup>67</sup>, është pyetur në datën 20.10.2010 në lidhje me kuotat e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., pasi nga verifikimi *online* në adresën [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al) rezulton se bashkëshorti E.K. ka shitur kuotat e kapitalit të shoqërisë në shumën 100,000 lekë dhe ky veprim nuk është deklaruar prej saj dhe, për këtë, ka shpjeguar se: “*Kam menduar ta deklaroj në DIPP-në e vitit 2010, pasi bashkëshorti ka qenë administrator i shoqërisë deri në datën 2.2.2010*”.

10.9 Nga të dhënat tatimore për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën 2005 – 2009, nuk rezulton të jetë shpërndarë dividend<sup>68</sup> dhe, si rrjedhojë, nuk provohet përfitimi i të ardhurave nga aktiviteti tregtar nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit.

Dividendi është e ardhur personale në rastin kur përfitohet nga një individ, si i tillë edhe tatimi paguhet nga individi përfitues dhe mbahet nga shoqëria që bën pagesën, e cila shërben si agjent tatimor për mbajtjen e tatimit në burim.

Për këtë arsye, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë në analizën financiare fitimin e realizuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ku personi i lidhur është ortak i vetëm i saj.

10.10 Subjekti, në ILDKPKI, në datën 20.10.2010, ka depozituar: (i) kontratën e blerjes së kuotave datë 10.11.2005<sup>69</sup>, me shitës M.Ç. dhe blerës E.K., i cili ble 100% të kuotave; (ii) si dhe kontratën e shitjes së kuotave datë 8.12.2009<sup>70</sup>, me shitës E.K. dhe blerës M.Ç. për shitjen e 100% kuotave të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me vlerën 100,000 lekë dhe pagesa është bërë në dorë jashtë zyrës noteriale.

10.11 QKB-ja<sup>71</sup> konfirmon se shtetasi E.K. figuron të ketë qenë administrator dhe ortak zotërues 100% i kapitalit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*, larguar si ortak datë 21.12.2009 dhe larguar si administrator datë 16.2.2010. Sipas ekstraktit të QKB-së, në datën 3.11.2011, shoqëria ndryshon emrin nga “\*\*\*\*” sh.p.k. në “\*\*\*\*” sh.p.k.

10.12 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “\*\*\*\*”/“\*\*\*\*” sh.p.k. dhe për administratorin/ortakun M.Ç. dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

10.13 Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti nuk kanë deklaruar shitjen e kuotave të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në DIPP-në e vitit 2009. Subjekti duhet të provojë shpërndarjen e dividendit në bazë të pasqyrave financiare për të ardhurat e pretenduara nga ky aktivitet, si dhe pagesën e tatimit mbi dividendin.

<sup>66</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2021, nga Bashkia Durrës.

<sup>67</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2020, nga ILDKPKI-ja, ka përcjellë procesverbalin datë 20.10.2010.

<sup>68</sup>Ligji nr. 7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare”, neni 70 “Reklamimi i dividendëve” dhe ligji nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, neni 77 “Shoqëria mund t’u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit”.

<sup>69</sup>Kontratën e blerjes së kuotave nr. \*\*\*, datë 10.11.2005.

<sup>70</sup>Kontrata e shitjes së kuotave nr. \*\*\*, datë 8.12.2009, të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

<sup>71</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2020, nga QKB-ja.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin D, të Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

10.14 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ndër të tjera, ka shpjeguar se, bazuar në përgjigjen e DRT-së Durrës, është e qartë që bashkëshorti ka pasur të ardhura dhe fitim, për të cilat është paguar tatimi i thjeshtuar mbi fitimin.

10.14.1 Subjekti vijon me shpjegimin se nëse do të ishte subjekt i tatimit të mbajtur në burim për dividendin bashkëshorti do të tatohej për këtë tatim. Në kushtet kur, sipas ligjit aktual nuk ka pasur detyrim për të paguar tatim mbi dividendin si biznes i vogël, e ardhura *neto* pas pagimit të tatimit mbi fitimin ka qenë edhe më e madhe. Bashkëshorti i saj ka realizuar xhiro vjetore më të vogël se vlera 8,000,000 lekë dhe i nënshtrohet tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Subjektet e tatimit të thjeshtuar të fitimit janë të ndryshëm nga subjektet e tatimit mbi fitimin, pasi subjektet e tatimit të thjeshtuar janë ato që quhen biznes i vogël, me qarkullim vjetor nën vlerën 8,000,000 lekë dhe që nuk janë subjekte të ligjit për TVSH-në. Kështu që të ardhurat nga biznesi i vogël, duke u konsideruar si të ardhura personale që tatoheshin me tatim të thjeshtuar fitimi, nuk tatoheshin dy herë, duke mbajtur edhe tatim mbi dividendin sepse e njëjta e ardhur, parimisht, nuk mund të tatohet me dy lloje tatimesh<sup>72</sup>.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

10.15 Komisioni vëren se referuar përmbajtjes fillestare të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” në germën “ë” të nenit 4 janë përcaktuar si burim të ardhurash, *të ardhurat nga dividendët e shpërndarë nga një person juridik, rezident*. Në ndryshimet e mëvonshme që ka pësuar ky ligj dhe, konkretisht, me ligjin nr. 9458, datë 21.12.2005, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, është shtuar neni 33/1, i cili përcakton mënyrën e destinimit të fitimit të shoqërive tregtare dhe në pikën 3 të tij përcaktohet detyrimi i personit juridik të derdhë për llogari të organit tatimor tatimin mbi dividendin e pagueshëm në rast se shoqëria ka vendosur të shpërndajë dividend. Pretendimi i subjektit se nuk ka pasur detyrim të paguajë tatim mbi dividendin për shkak se ka qenë subjekt tregtar me përgjegjësi tatimore tatim i thjeshtuar mbi fitimin dhe jo tatim fitimin, nuk qëndron, pasi ky nen detyron personin juridik me të njëjtën formë juridike, si dhe shoqëria “\*\*\*\*\*/\*\*\*\*\*” sh.p.k., të paguajë tatim mbi dividendin për fitimin e destinuar si dividend.

10.16 Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ka paguar tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe se me pagimin e tatimit mbi dividendin do të tatoheshin dy herë, ky pretendim nuk qëndron sepse pagesa e tatimit të thjeshtuar është pagesë tatimi për të ardhurat e krijuara nga shoqëria tregtare, personi juridik, ndërsa pagesa e tatimit mbi dividendin është pagesë tatimi për të ardhurat personale të ortakut të shoqërisë dhe, si e tillë, nuk është pagesë tatimi për të njëjtën të ardhur. Kjo është e pasqyruar edhe në nenin 8 të ligjit nr. 8438, i cili ka përcaktuar si të ardhur personale të tatueshme të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionerit në shoqërinë tregtare.

Referuar të dhënave tatimore të shoqërisë “\*\*\*\*\*/\*\*\*\*\*” sh.p.k. rezulton se ka realizuar fitim si shoqëri, për të cilin ka paguar tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, por nuk rezulton të ketë shpërndarë dividendë te ortakut i vetëm i shoqërisë, E.K., duke nënkuptuar që ky fitim nuk është shpërndarë, por ka mbetur në shoqëri dhe, si i tillë, nuk mund të pretendohet nga subjekti si e ardhur e ligjshme për aq kohë sa nuk është shpërndarë dhe paguar tatimi sipas ligjit.

---

<sup>72</sup>Shihni shpjegimet e subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit të detajuara.



Komisioni ka marrë në konsideratë pagat e personit të lidhur me subjektin, bashkëshorti i saj, në këtë shoqëri sipas të dhënave nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës të depozituara nga subjekti bashkë me deklaratën vetting si dhe në prapësimet e tij<sup>73</sup>.

10.16.1 Për sa më lart, Komisioni vlerëson se është forma ligjore e shoqërisë ajo që përcakton mënyrën e tërheqjes së fitimit të realizuar dhe, si rrjedhojë, edhe detyrimin e pagimit të tatimit mbi këtë fitim dhe jo përgjegjësia tatimore ashtu siç i referohet subjekti.

**Komisioni arrin në konkluzionin se të ardhurat e shoqërisë “\*\*\*\*”/ “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën 3.7.2006 – 21.12.2009, në shumën 10,002,316 lekë, të pretenduara nga subjekti, nuk plotësojnë kriterin e të ardhurave të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe, për këtë arsye, nuk i ka marrë në konsideratë në analizën financiare.**

❖ **Personi i lidhur me subjektin/ djali A.K.**

### **11. Automjet, tip “Volkswagen Passat”, me targa \*\*\*, i vitit 2008**

Ky automjet është blerë me kontratën e datës 16.6.2014<sup>74</sup>, në vlerën 5,500 euro. Pjesa takuese: 100 %.

Burimi i krijimit: të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit të mëparshëm me kontratën, datë 14.6.2014<sup>75</sup>.

11.1 Subjekti e ka deklaruar këtë automjet në DIPP-në e vitit 2014: *“Blerje makine djalit A.K., e markës ‘Volkswagen Passat’, viti 2008, në shumën 5,500 euro, me kontratën nr. \*\*\*, datë 16.6.2014”*.

11.2 DPSHTRR-ja<sup>76</sup> ka përcjellë dosjen e automjetit tip “Volkswagen Passat”, me targa \*\*\*, i vitit 2008. Ky automjet është blerë nga shtetasit M. dhe I.Ll. në datën 2.5.2014<sup>77</sup> shoqërisë “Raiffeisen Leasing” sh.a., me çmimin 5,500 euro, paguar në llogarinë bankare.

11.2.1 Me kontratën e datës 16.6.2014, shitësit M. dhe I.Ll. ia kanë shitur blerësit A.K. automjetin tip “Volkswagen Passat”, me çmimin 5,500 euro.

11.3 Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit në DIPP-në e vitit 2014 dhe i kërkuar shpjegime me pyetësin nr. 2.

Subjekti ka shpjeguar se burimi i krijimit të automjetit tip “Volkswagen Passat”, me targa \*\*\*, është shitja e automjetit në vitin 2014 në shumën 5,500 euro.

11.4 *Analizë e burimit të krijimit të shumës 5,500 euro nga shitja e automjetit të mëparshëm me targa \*\*\*, që ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Passat”*

11.4.1 Subjekti e ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në DIPP-në e vitit 2013 në shumën 2,000 euro dhe shitjen e tij në vitin 2014 në shumën 5,500 euro.

11.4.2 Subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes së automjetit, datë 14.6.2014<sup>78</sup>, me shitës A.K. dhe blerës E.D., për çmimin 5,500 euro.

<sup>73</sup> Vërtetim nga DRSSH Durrës nr. \*\*\* prot., datë 23.8.2021

<sup>74</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 14.6.2014.

<sup>75</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 14.6.2014.

<sup>76</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2020, e DPSHTRR-së.

<sup>77</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 2.5.2014.

<sup>78</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 14.6.2014.

11.4.3 DPSHTRR-ja<sup>79</sup> ka përcjellë dosjen e automjetit me targa \*\*\*, ku janë edhe dy kontratat e lartpërmendura, përkatësisht e blerjes së automjetit, datë 13.9.2013<sup>80</sup>, nga shtetasi A.K. dhe ajo e shitjes së automjetit, datë 14.6.2014, po prej tij.

11.4.4 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë konflikti interesi të subjektit me shtetasit E.D. dhe V.Xh. dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë<sup>81</sup>.

11.4.5 Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/djali A.K. nuk kanë paguar tatimin mbi të ardhurat për diferencën e çmimit të blerjes me atë të shitjes.

11.4.6 Subjekti, në pyetësozin nr. 2, kur është pyetur për pagesën e tatimit mbi të ardhura për një automjet tjetër, ka deklaruar se ajo dhe bashkëshorti dhe nuk kanë qenë në dijeni të këtij detyrimi dhe për këtë arsye subjekti ka bërë këto pagesa në gusht të vitit 2021, duke vënë në dispozicion të Komisionit mandatin përkatës të pagesës, siç është përshkruar në pikën 8.4.5 të vendimit.

11.4.7 Komisioni, referuar edhe praktikës së ndjekur nga Kolegji, në analizën financiare ka marrë në konsideratë të ardhurat nga shitja e automjetit deri në nivelin e çmimit të blerjes, pa përfshirë fitimin e realizuar nga shitja, pasi në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës nuk konsiderohen të ardhura të ligjshme.

Si burim i ligjshëm për blerjen e automjetit me targa \*\*\* do të konsiderohet vetëm shuma 2,000 euro nga çmimi i shitjes prej 5,500 euro.

11.5 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

- personi i lidhur/djali A.K. ka mungesë burimesh në shumën 3,500 euro për blerjen e automjetit me targa \*\*\*,
- subjekti i rivlerësimit ka paguar tatimin mbi fitimin e diferencës së çmimit pas procesit të rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe detyrimi tatimor nuk është paguar i plotë (detyrimi kryesor + kamatëvonesat + gjobat).

Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

11.6 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se Komisioni duhet të marrë në konsideratë në vitin 2012 të ardhurat nga paga e djalit A.K., sipas përgjigjes, datë 23.8.2021, të ISSH-së, të ardhura këto të kursyera dhe të përdoruar për blerjen e automjetit.

11.6.1 Në lidhje me mospagimin e plotë të tatimit për diferencën e çmimit të shitjes së automjeteve, tatim i paguar pas procesit të rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti ka shpjeguar se nuk rezulton që t'i jetë bërë rivlerësim i detyrimit tatimor nga organi kompetent.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

11.7 Komisioni vëren se pretendimi i subjektit për të marrë në konsideratë të ardhurat nga paga e djalit në vitin 2012, nuk qëndron, pasi këto të ardhura nuk mund të jenë burim për blerjen e

---

<sup>79</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2020, e DPSHTRR-së.

<sup>80</sup>Kontratë nr. \*\*\*, datë 13.9.2013.

<sup>81</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Vendimet: nr. \*\*\*, datë 29.10.2004, me palë V.Xh., gjykuar nga gjyqtari M. M.; nr. \*\*\*, datë 7.7.2015, me palë E.D., gjykuar nga gjyqtari T. H.; nr. \*\*\*, datë 26.7.2011, me palë E.D., gjykuar nga gjyqtari Sh.P.; nr. \*\*\*, datë 8.2.2012, me palë E.D., gjykuar nga gjyqtari A. M.

automjetit, pasi subjekti ka deklaruar më herët në deklaratën *Vetting* si burim të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm dhe jo kursimet nga paga, në këtë rast ajo ka ndryshuar burimin e krijimit të automjetit. Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të vitit 2012 të ardhurat nga pagat e djalit (të konfirmuara nga ISSH-ja), të cilat kanë shërbyer për të paguar shpenzimet.

11.7.1 Pretendimi i subjektit se nuk ka një vlerësim tatimor në lidhje me mospagesën e plotë të tatimit, nuk qëndron. Subjekti nuk e ka deklaruar të ardhurën në momentin e krijimit, por shumë kohë më vonë, pas procesit të rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Si rrjedhojë, detyrimi është gjeneruar në momentin e deklarimit, i cili është ai pas procesit të rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Subjekti, me deklarimin e detyrimit tatimor, ka kryer edhe pagesën e tij. Në këto kushte, administrata tatimore nuk ka gjeneruar kamatëvonesat dhe gjobat sepse nga momenti i deklarimit të detyrimit në deklaratën *Vetting* deri në pagesën e tij nuk ka kaluar kohë, në kundërshtim me afatet që të jep ligji për pagesën e tatimit në burim. Nëse subjekti do të kishte deklaruar të ardhurën në momentin e krijimit (kur është shitur automjeti), detyrimi tatimor do të ishte gjeneruar në atë moment dhe deri në datën e pagesës, gusht të vitit 2021, si dhe do të kishte gjeneruar kamatëvonesat dhe gjoba. Gjithashtu, subjekti/personi i lidhur nuk kanë dokumentuar që të kenë bërë riparime/përmirësime të automjetit që mund të kenë ndikuar në rritjen e vlerës së tij.

**Komisioni arrin në konkluzionin se personi i lidhur/djali A.K. ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 3,500 euro për blerjen e automjetit.**

## KONSTATIME TË TJERA

**12. Hua në shumat 10,000 euro, në vitin 2005 dhe 10,000 euro në vitin 2006, dhënë nga shtetasi D.H. (djali i tezes së subjektit)**

12.1 Në DIPP-në e vitit 2005 subjekti ka deklaruar: *“Marrë borxh për kompletim të shtëpisë nga djali i tezes D.H. 10,000 euro. Depozituar në bankën PCB shuma e marrë borxh”*.

12.2 Subjekti, në ILDKPKI në vitin 2010, në lidhje me huat e marra nga shtetasi D.H. në shumat 10,000 euro në vitin 2005 dhe 10,000 euro në vitin 2006, ka shpjeguar se huaja e marrë në vitin 2005 është shlyer 7,000 euro me kredinë e marrë në NBG në dhjetor, ndërsa huaja e vitit 2006 është marrë vetëm për efekt vize në ambasadë dhe është kthyer menjëherë.

12.3 Në pyetësin nr. 1 subjekti ka deklaruar se i ka marrë hua shtetasit D.H. shumën 20,000 euro të likuiduar në vite, ndërkohë që në deklaratën noteriale të datës 21.2.2020<sup>82</sup> ky shtetas ka deklaruar se për huan e dhënë në vitin 2005 shtetasja Eda Kaja i ka kthyer shumën 7,000 euro me bankë në dhjetor të vitit 2005 dhe shumën 3,000 euro ia ka kthyer me vlera të vogla, deri para pak kohësh. Huaja e dhënë prej 10,000 euro në vitin 2006 shtetasi D.H. deklaroi se i është kthyer *cash*.

12.3.1 Subjekti ka depozituar si dokument provues për të ardhurat prej 20,000 euro ekstrakt të shoqërisë “D. H. Konstruksion” sh.p.k., regjistruar në datën 19.3.2007, me administrator dhe ortak të vetëm shtetasin D.H.

12.4 Komisioni, me pyetësin nr. 2, i ka kërkuar subjektit të provojë me dokument ligjor burimin e ligjshëm të huave të dhëna nga shtetasi D.H.

12.4.1 Subjekti ka shpjeguar se në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit D.H. ka depozituar llogaritë bankare në euro të tij për periudhën 2004 – 2006, ku rezultoi se shumat e dhëna hua kanë qenë në gjendje në llogaritë e tij. Mesa ka dijeni subjekti, të ardhurat e shtetasit D.H. burojnë nga aktiviteti i tij privat që ka ushtruar prej shumë vitesh në shtetin italian.

<sup>82</sup>Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 21.2.2020, e depozituar nga subjekti bashkëlidhur pyetësorit nr. 1.

12.5 Komisioni vëren se nxjerrja e llogarive bankare të shtetasit D.H. nuk mund të shërbejë si dokument ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të huave, pasi pavarësisht konfirmimit të veprimeve bankare lidhur me dhënien e huas, nuk konfirmohet ligjshmëria e shumave në llogarinë bankare të këtij shtetasi. Në këto kushte, Komisioni nuk ka marrë në analizë financiare huan e marrë në vitin 2005.

12.5.1 Në lidhje me huan e marrë në vitin 2006, pavarësisht se nuk provohet burimi i ligjshëm i huadhënësit në analizën financiare, nuk është marrë në konsideratë as dhënia e huas dhe as kthimi i saj, pasi, siç konstatohet edhe nga llogaria bankare, ajo rezulton të jetë kthyer brenda një kohe shumë të shkurtër, brenda vitit.

12.6 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

- subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokument ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit D.H. për huat e dhëna në shumën 10,000 euro në vitin 2005 dhe në shumën 10,000 euro në vitin 2006;
- ka deklarime kontradiktore të subjektit të rivlerësimit referuar shlyerjes së huas së marrë në vitin 2005 me deklarimin e huadhënësit D.H., për arsye se në ILDKPKI subjekti ka deklaruar se pjesa prej 3,000 euro i është kthyer huadhënësit në vitin 2006, ndërsa në deklaratën noteriale të datës 20.1.2020 huadhënësi D.H. deklaroi se kjo shumë është kthyer me shuma të vogla deri para pak kohësh;
- subjekti nuk ka deklaruar huan prej 10,000 euro marrë në vitin 2006 në DIPP-në e vitit 2006;
- subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme për shlyerjen e huave, pasi rezulton me balancë negative për vitet 2005 – 2006.

Për konstatimet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

12.7 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se ka pasur një marrëdhënie huamarrjeje afatshkurtër për shumën prej 10,000 euro, ku 7,000 euro janë shlyer brenda vitit dhe provohet se nga kjo marrëdhënie huamarrjeje nuk konstatohet që të ketë realizuar shtim apo pakësim të pasurisë.

12.7.1 Në lidhje me pasaktësitë dhe mosdeklarimet në kohë të veprimeve juridike, subjekti ka shpjeguar se ato janë gabime njerëzore, të paqëllimta dhe që nuk kanë të bëjnë me asnjë aspekt të fshehjes apo deklarimit të rremë ose të pasaktë, si një deklaram të pamjaftueshëm.

12.7.2 Në lidhje me mundësinë financiare të shtetasit D.H., subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, përpos të ardhurave nga lëvizjet e tij të llogarive bankare, të depozituara në Komision në pyetësin nr. 2, ky shtetas ka jetuar dhe punuar prej shumë vitesh në shtetin italian, ku ka qenë ortak i një shoqërie tregtare e regjistruar pranë këtij vendi.

Subjekti ka depozituar në prapësime dhe seancën dëgjimore kontratën e shitjes së kuotave të vitit 2005<sup>83</sup>, ku shtetasi D.H. dhe bashkëshortja e tij përfitojnë 20,000 euro nga shitja e kuotave të shoqërisë, si dhe kontratën e blerjes<sup>84</sup> së një apartamenti në vlerën 70,000 euro në të njëjtën ditë.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

---

<sup>83</sup>Kontratë nr. \*\*\*, datë 2.3.2005, sipas formës së kërkuar nga ligji.

<sup>84</sup>Kontratë nr. \*\*\*, datë 2.3.2005, sipas formës së kërkuar nga ligji.

12.8 Komisioni vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se huaja e marrë nga shtetasi D.H. është përdorur vetëm për shumën 3,000 euro, bie në kundërshtim me veprimet bankare, ku evidentohet se në datën 4.10.2005 bashkëshorti i subjektit ka kaluar 5,000 euro në depozitë me afat nga huaja prej 10,000 euro, e marrë nga ky shtetas. Tërheqjet *cash* të depozitës së maturuar dhe pjesës së mbetur të huas janë deklaruar në pyetësorë nga subjekti se janë përdorur për arredim ose krijimin e gjendjes *cash* në banesë.

12.8.1 Komisioni vëren se në kuptim të ligjit nr. 84/2016, shtetasi D.H. është person tjetër i lidhur dhe referuar kriterit të proporcionalitetit subjekti i rivlerësimit ka provuar me dokumentacion burimin e ligjshëm të shumës 10,000 euro, dhënë hua nga ky shtetas në vitin 2005 dhe, për këtë arsye, e përfshiu në analizën financiare. Komisioni nuk e përfshiu në analizën financiare huan e marrë në vitin 2006, për shkak se u kthye brenda një kohe shumë të shkurtër dhe nuk rezultoi të ishte përdorur nga subjekti i rivlerësimit për krijimin e ndonjë pasurie.

**Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë të huas së marrë nga shtetasi D.H., në kundërshtim me pikën 5/a, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.**

Subjekti i rivlerësimit ka provuar me dokument ligjor mundësinë financiare të huadhënësit D.H. në lidhje me huan prej 10,000 euro të marrë në vitin 2005.

### **13. Hua në shumën 20,000 euro, marrë shtetasit I.H. në datën 13.9.2010**

13.1 Rezulton se kjo hua është deklaruar në DIPP-në e vitit 2010 që është marrë për efekt vize në ambasadë më 13.9.2010 dhe shlyer në datën 28.9.2010, pasi janë depozituar vetëm për disa ditë në “Union Bank”.

13.2 Subjekti ka depozituar në ILDKPKI në vitin 2012 deklaratën noteriale, datë 12.3.2011, të shtetasit I.H., i cili deklaron dhënien e huas të shumës 20,000 euro shtetasit E.K., në datën 13.9.2010, për efekt vize ambassade, e cila i është kthyer në datën 28.9.2010.

13.3 Si dokument provues për të ardhurat në shumën 20,000 euro, dhënë hua nga shtetasi I.H., subjekti ka depozituar certifikatë regjistrimi të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*, por nuk përcakton administratorin apo ortakun.

13.4 Komisioni ka bërë verifikimin *online* të NIPT-it të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. në faqen zyrtare të QKB-së [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al), nga ku rezultoi se kjo shoqëri është regjistruar në datën 1.1.2003 dhe shtetasi I.H. rezulton administrator i saj nga data 30.11.2007 dhe ortak me 30 % të kapitalit.

13.5 Komisioni, me pyetësorin nr. 2, i ka kërkuar subjektit të provojë me dokumentacion burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit I.H. për dhënien e huas në shumën 20,000 euro.

13.5.1 Subjekti ka shpjeguar se burimi i të ardhurave të shtetasit I.H. vërtetohet nga llogaritë e tij bankare, i cili ushtron aktivitetin e këmbimit valutor. Subjekti ka depozituar një nxjerrje llogarie bankare të këtij shtetasi nga “Union Bank” për periudhën 1.1.2010 – 31.12.2010.

13.6 Komisioni vëren se nxjerrja e llogarive bankare të shtetasit I.H. nuk mund të shërbejë si dokument ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të huas, pasi nuk konfirmohet ligjshmëria e shumave në llogarinë bankare.

13.7 Në analizën financiare nuk është marrë në konsideratë as marrja e huas dhe as kthimi i saj, pasi, siç konstatohet edhe nga veprimet bankare, ajo rezulton të jetë kthyer brenda një kohe shumë të shkurtër (13.9.2010 – 28.9.2010) dhe nuk është përdorur si burim nga subjekti i rivlerësimit, për të cilën ka bashkëlidhur në pyetësorin nr. 1 kopje të vizës së marrë në datën 23.9.2010.

13.8 Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme të konfliktit të interesit të subjektit me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetasit I.H., si ortak i saj dhe si individ, dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë<sup>85</sup>.

**Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokument burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit I.H., që kanë shërbyer si hua, por nuk ka marrë në konsideratë as marrjen dhe as kthimin e kësaj huaje, pasi nuk rezulton të jetë përdorur si burim nga subjekti i rivlerësimit.**

#### **14. Automjet, tip “Ford RTB”, me targa \*\*\*, i vitit 1999, në shumën 450 euro, dhuruar nga vjehrra e subjektit/G.K.**

14.1 Subjekti, në DIPP-në e vitit 2011, në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale”, ka deklaruar: “*Autoveturë e markës ‘Ford RTB’ me targa \*\*\*, prodhim i vitit 1999, në vlerën 450 euro, dhuruar nga vjehrra G.K. me kontratë dhurimi nr. \*\*\*, datë 20.12.2011*”.

14.1.1 Subjekti e ka deklaruar shitjen e këtij automjeti në DIPP-në e vitit 2013 në shumën 3,000 euro.

14.2 DPSHTRR-ja<sup>86</sup> ka përcjellë dosjen e automjetit me targa \*\*\*, nga ku rezulton se është blerë në datën 16.10.2009 nga shtetasja G.K. (banuese në Itali) për çmimin 400 euro, automjet i cili ka kaluar në pronësi të kësaj shtetaseje (leja e qarkullimit italiane). Dokumenti doganor i datës 1.12.2011 pasqyron pagesën prej 15,733 lekësh në doganën e Durrësit nga shtetasja G.K. (vlera 400 euro llogaritur me kursin 141.75 lekë/euro). Me kontratën e dhurimit, datë 20.12.2011<sup>87</sup>, shtetasja G.K. ia dhuron këtë automjet pranueses së dhurimit Eda Kaja.

14.2.1 Më pas, me kontratën e datës 6.5.2013<sup>88</sup>, shtetasja Eda Kaja ia shet blerësit L.J. këtë automjet me çmimin 3,000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

14.3 Komisioni, me pyetësorin nr. 2, i ka kërkuar subjektit të provojë me dokument ligjor pagesën e tatimit mbi të ardhura për diferencën e çmimit të shitjes (në këtë rast automjeti është dhuruar) me atë të shitjes (ku subjekti ka përfituar shumën 3,000 euro).

14.3.1 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ligji nuk parashikonte penalitete të tilla për pagimin e tatimit mbi të ardhurat me vonesë dhe nuk e pengon individin t’i paguajë në një moment të mëvonshëm. Subjekti ka vënë në dispozicion mandatpagesën e kryer për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të të tria automjeteve të tjetërsuara nga familja, përkatësisht me targat \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, në shumën totale prej 222,291 lekësh.

14.4 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se edhe për këtë automjet subjekti ka paguar tatimin mbi fitimin e diferencës së çmimit pas procesit të rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe detyrimi tatimor nuk është paguar i plotë (detyrimi kryesor + kamatëvonesat) dhe, për rrjedhojë, shuma e marrë në analizën financiare është 71.053 lekë (400 euro + 15,733 lekë).

Për konstatimin e mësipërm, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

<sup>85</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Vendimet: nr. \*\*\*, datë 30.5.2019, me palë I.H., gjykuar nga gjyqtari N. T.; nr. \*\*\*, datë 18.2.2019, me palë shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., përfaqësuar nga shtetasi I.H., gjykuar nga gjyqtari B. G.; nr. \*\*\*, datë 14.1.2019, me palë I.H., gjykuar nga gjyqtari P. Ç.; nr. \*\*\*, datë 8.3.2019, me palë I.H., gjykuar nga gjyqtari J. Q.; nr. \*\*\*, datë 30.7.2018, me palë I.H., gjykuar nga gjyqtari M. K.

<sup>86</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2020, e DPSHTRR-së.

<sup>87</sup>Kontratë dhurimi nr. \*\*\*, datë 20.12.2011.

<sup>88</sup>Kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 5.6.2013.

14.5 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj dhe gjatë seancës dëgjimore, ka dhënë të njëjtat shpjegime si ato të automjeteve të tjera të analizuara më lart. Subjekti ka deklaruar se kuadri ligjor nuk parashikonte pagimin e një tatimi të tillë dhe nuk pengonte pagimin e tij në një kohë të mëvonshme. Subjekti ka referuar mandatpagesën e pagimit të këtij tatimi për të tria automjetet.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

14.5.1 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka paguar tatimin mbi të ardhurat për diferencën e çmimit të blerjes me të shitjes me vonesë për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Pagesa e bërë nga subjekti i rivlerësimit nuk përfshin detyrimin e plotë bashkë me gjobat dhe kamatëvonesat. Gjithashtu, subjekti/personi i lidhur nuk kanë dokumentuar që të kenë bërë riparime/përmirësime të automjetit që të mund të kenë ndikuar në rritjen e vlerës së tij.

14.6 Komisioni ka marrë në analizë vetëm çmimin e blerjes së këtij automjeti në Itali nga shtetasja G.K.

**Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e automjetit dhe për këtë arsye këto të ardhura nuk plotësojnë kriterin e të ardhurave të ligjshme, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.**

### **❖ Pasuri, veprime financiare pas dorëzimit të deklaratës *Vetting***

**15. Hua në shumën 15,000 euro, marrë shtetasit V.Xh. në vitin 2019**

**16. Pasuri e paluajtshme apartament, me sip. 51.60 m<sup>2</sup>**

Ky apartament është në emër të shtetasës G.K. (vjehrra e subjektit) me adresë: h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Lagjja \*\*\*, Plazh, Durrës, blerë në datën 16.4.2018, me vlerë 17,000 euro.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

Komisioni ka vlerësuar të mos i hetojë këto pasuri apo veprime të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur/të tjerë të lidhur me të, pas plotësimit të deklaratës *Vetting*.

**17. Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016**

17.1 Gjatë hetimit administrativ, nga analiza e deklaratave të interesave pasurore private/vjetore dhe asaj *Vetting* për periudhën e hetimit 2003 – 2016, të kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë, në shumën 12,545,533 lekë.

Për konstatimin e mësipërm, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

17.2 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka kryer një analizë financiare ku ka paraqitur dhe shpjeguar mospërputhjet e analizës së kryer prej tij dhe analizës financiare të kryer nga Komisioni, duke argumentuar çdo të ardhur, hua, shpenzim apo ndryshime në gjendjen e likuiditeteve të marra në konsideratë në këtë analizë. Në analizën financiare për periudhën 2003 – 2016 subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni duhet të marrë në konsideratë:

- a) Gjendjen *cash* për periudhën 2003 – 2007, të deklaruar më parë edhe në pyetësorë, si vijon: gjendje *cash* më 31.12.2002, në shumën 2,000,000 lekë; gjendje *cash* më 31.12.2003, në shumën 1,280,000 lekë; gjendje *cash* më 31.12.2004, në shumën 5,233,700 lekë; gjendje

*cash* më 31.12.2005, në shumën 1,000,000 lekë; gjendje *cash* më 31.12.2006, në shumën 1,000,000 lekë; si dhe gjendje *cash* më 31.12.2007, në shumën 1,000,000 lekë.

- b) Të ardhurat nga shitja e banesës në emër të bashkëshortit, vjehrrës dhe kunatit, në shumën 4,000,000 lekë në vitin 2004, pasi kjo shumë është deklaruar në deklaratat periodike vjetore si dhe atë *Vetting* dhe është pasqyruar dhe evidentuar pikërisht nëpërmjet transaksionit bankar. Në lidhje me kontratën që rezulton e depozituar pranë regjistrave publikë në shumën 2,000,000 lekë, subjekti ka shpjeguar se procedurat janë kryer prej vjehrrës, e cila ka paguar shumën e përcaktuar nga ZVRPP-ja.
- c) Të ardhurat në shumën 6,144,969 lekë nga aktiviteti i bashkëshortit, për periudhën 2006 – 2013, pasi ai nuk ka pasur detyrim për pagesë dividendi.
- d) Të ardhurat nga shitja e dyqanit në shumën 23,000 euro (e konvertuar në 2,833,198 lekë) për vitin 2008, pjesa e saj takuese sipas kontratës së premtim-shitjes.
- e) Të ardhurat në shumën 100,000 lekë nga shitja e aksioneve të kantinës së pijeve për vitin 2009.
- f) Të ardhurat në shumën 375,146 lekë<sup>89</sup> nga paga e bashkëshortit për vitet 2012 - 2013.
- g) Të ardhurat në shumën 5,500 euro (konvertuar në 770,605 lekë) në vitin 2014 nga shitja e automjetit me targa \*\*\*.
- h) Shpenzimet në shumën 1,059,400 lekë në vitin 2008 dhe nga 200,000 lekë për vitet 2009 - 2010 për mobilimin e banesës.
- i) Të ardhurat në shumën 216,720 lekë<sup>90</sup> nga paga e djalit për vitin 2012.
- j) Huan e marrë në shumën 10,000 euro nga shtetasi D.H., por për efekt të analizës duhet të llogaritet vetëm shuma e përdorur prej 3,000 euro.
- k) Faktin që në të gjitha udhëtimet në Itali subjekti dhe personat e lidhur kanë qëndruar në banesës e nënës së bashkëshortit, në adresën: \*\*\*

Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se Komisioni:

- l) Nuk duhet të përfshijë shpenzimet e llogaritura në shumën 5,960 euro në vitin 2005 sepse nga shumën e tërhequra *cash* dhe pagesat me kartë (15.960 euro ku 5,960 euro janë pagesë me kartë), shuma 10,000 euro është përdorur për mobilimin e apartamentit dhe pjesa tjetër është rikrijuar gjendje *cash* në banesë.
- m) Nuk duhet të llogarisë shumën 27,000 euro si shpenzim/pagesë të kryer për apartamentin sepse nuk është e mbështetur me dokumentacion ligjor.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

17.3 Komisioni, në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit të ngritura gjatë hetimit, në prapësime dhe në seancën dëgjimore, vëren se:

17.3.1 Subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaratime të gjendjes *cash* në DIPP-të përkatëse dhe për këtë arsye Komisioni nuk i ka marrë në konsideratë në analizën financiare.

17.3.2 Për të ardhurat nga shitja e banesës së bashkëshortit nuk u provua me dokumentacion pagesa e tatimit për shumën 4,000,000 lekë, por Komisioni ka marrë në konsideratë në analizën financiare për vitin 2004 vetëm shumën 2,000,000 lekë si të ardhur të ligjshme, për të cilën është paguar tatimi, si dhe gjendje *cash* në vitin 2004 në shumën 4,000,000 lekë.

<sup>89</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.8.2021, e DRSSH-së Durrës.

<sup>90</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.8.2021, e DRSSH-së Durrës.



17.3.3 Në DIPP-në e vitit 2005 nuk rezulton deklarim i gjendjes *cash* dhe për këtë arsye shuma 15,960 euro, e tërhequr *cash*/paguar me bankë nga subjekti në vitin 2005, është konsideruar si shpenzim në analizën financiare, nga ku shuma 10,000 euro është përdorur për mobilimin e apartamentit dhe pjesa tjetër prej 5,960 euro është shpenzuar.

17.3.4 Subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me shumën 27,000 euro të deklaruar në DIPP-në e vitit 2006 dhe për këtë arsye Komisioni nuk e përfshiu këtë shumë në analizën financiare si pagesë/shpenzim për apartamentin.

17.3.5 Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion shpërndarjen dhe pagesën e tatimit mbi dividendin për të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit, si dhe shuma e pretenduar në prapësime është e ndryshme nga shuma e deklaruar prej tij në deklaratën *Vetting* dhe për këtë arsye shuma e pretenduar nuk u mor në konsideratë nga Komisioni.

17.3.6 Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar pagesën e tatimit për të ardhurat nga shitja e dyqanit në shumën e pretenduar 23,000 euro dhe për këtë arsye Komisioni nuk i mori në konsideratë këto të ardhura, duke i llogaritur në vlerën 0 (zero) lekë.

17.3.7 Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar pagesën e tatimit për të ardhurat nga shitja e aksioneve të kantinës dhe për këtë arsye shuma 100,000 lekë në vitin 2009 nuk është marrë në konsideratë në analizën financiare.

17.3.8 Paga e bashkëshortit për vitet 2012 – 2013, referuar vërtetimit të ISSH-së, është në shumën 291,509 lekë dhe u përfshi në analizën financiare.

17.3.9 Subjekti i rivlerësimit ka paguar tatimin për diferencën e të ardhurës nga shitja e automjetit pas procesit të rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe për këtë arsye kjo e ardhur në analizën financiare është marrë në llogaritje sa çmimi i blerjes prej 280,420 lekësh.

17.3.10 Subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me shpenzimet e mobilimit, të cilat janë përfshirë në analizën financiare sipas shpjegimeve të saj.

17.3.11 Subjekti i rivlerësimit ka provuar me dokumentacion ligjor të ardhurat nga paga e djalit dhe për këtë arsye Komisioni i përfshiu në analizën financiare për vitin 2012 në shumën 210,576 lekë dhe për vitin 2013 në shumën 8,610 lekë.

17.3.12 Subjekti i rivlerësimit ka provuar burimin e ligjshëm të shumës 10,000 euro, marrë hua nga shtetasi D.H. në vitin 2008, e cila u përfshi në analizën financiare.

17.3.13 Komisioni, në analizën dërguar me rezultatet e hetimit, ka marrë në konsideratë në llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit faktin e qëndrimit të shtetases G.K.

Për sa më sipër, pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti në prapësime dhe në seancë dëgjimore, Komisioni rishikoi analizën financiare, për periudhën 2003 – 2016, nga ku rezultoi se pamundësia financiare e subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe pasuritë e tij rezultoi në vlerën 8,086,347 lekë nga 12,545,533 lekë që ishte para prapësimeve.

**Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, për periudhën 2003 – 2016, rezulton me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 8,086,347 lekë.**

Përshkrimi	Para 2003	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>Të ardhurat</b>		<b>630,957</b>	<b>3,010,831</b>	<b>897,706</b>	<b>964,753</b>	<b>1,146,116</b>	<b>1,258,470</b>	<b>1,865,054</b>	<b>1,213,883</b>	<b>1,207,866</b>	<b>1,394,546</b>	<b>1,389,998</b>	<b>1,886,285</b>	<b>1,932,142</b>	<b>1,648,596</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	2,630,160	580,957	760,831	770,422	823,429	789,754	785,670	934,112	966,083	1,012,613	1,112,563	1,090,233	1,399,872	1,399,872	1,407,381
Të ardhura nga paga e b'shortit Kantina e verës	907,249	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga paga e b'shortit autoshkolla	-	-	-	127,284	141,324	356,362	472,800	472,800	247,800	124,200	-	-	-	-	-
Të ardhura nga paga e djalit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	210,576	8,610	-	-	-
Të ardhura nga fitimi si ortak i vetëm 03.07.2006-21.12.2009	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura si specialist zyre te Aluzini	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	71,407	220,102	205,993	532,270	241,215
Të ardhura nga shitja e një trualli në b'pronësi 1/6 e 450 m2 në vlerën 1.00	160,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga shitja e shitëpisë së bashkëshortit	-	-	2,000,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga shitja e aksioneve te Kaninës së pjeve *****	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga shitja e dyqanit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga dhurimi i pjesës takuese të shitëpisë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga shitja e mjetit *****	-	-	250,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga shitja e mjetit *****	-	-	-	-	-	-	-	358,142	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga shitja e mjetit *****	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	71,053	-	-	-
Të ardhura nga shitja e mjetit *****	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	280,420	-	-
Të ardhura nga shitja e mjetit *****	-	50,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura nga dhurimi G***** K***	-	-	-	-	-	-	-	-	-	71,053	-	-	-	-	-
Të ardhura nga shitja e kuotave ***** shpk	-	-	-	-	-	-	-	100,000	-	-	-	-	-	-	-
<b>Detyrime</b>				<b>2,450,800</b>			<b>3,695,475</b>								
Kredi BKT 23.12.2005 10,000 Euro për punime në ap				1,225,400											
Kredi NBG 22.04.2008 30,000 Euro për blerje apartamenti							3,695,475								
Hua D***** H***** 10,000 Euro 10.03.2005				1,225,400											
Hua D***** H***** 10,000 Euro 30.05.2006															
Hua I***** H***** 20,000 Euro 13.09.2010															
<b>Shpenzime</b>	<b>1,155,894</b>	<b>382,456</b>	<b>574,892</b>	<b>3,307,410</b>	<b>1,053,507</b>	<b>952,923</b>	<b>6,416,731</b>	<b>1,473,571</b>	<b>1,255,034</b>	<b>1,008,701</b>	<b>1,155,035</b>	<b>966,009</b>	<b>1,372,027</b>	<b>1,485,019</b>	<b>1,613,323</b>
Shpenzime jetike	1,155,894	375,456	375,456	438,228	438,228	546,480	546,480	546,480	546,480	546,480	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime mobilimi	-	-	-	1,225,400	-	-	1,059,400	200,000	200,000	-	-	-	-	-	-
Shpenzime të tjera	-	-	-	730,338	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzime udhëtimi	-	-	177,436	-	86,592	209,779	-	275,026	398,330	334,629	459,163	241,161	377,130	264,187	280,073
Shpenzime shkollimi A*** K***	7,000	22,000	25,000	28,000	28,000	32,500	25,000	-	-	-	17,241	44,016	-	206,475	338,175
Shpenzime shkollimi M*** K***	-	-	-	-	-	37,500	42,000	48,000	50,000	52,000	54,000	57,000	60,000	63,000	-
Shpenzime doganore	-	-	-	-	-	-	-	345,022	-	15,733	-	-	-	-	-
Shpenzime principli+ interesi+kom+sig. NBG 10,000	-	-	-	30,663	129,578	126,664	1,250,675	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzime principli+ interesi+kom+sig. NBG 30,000	-	-	-	-	-	-	3,493,176	59,043	60,224	59,859	60,535	59,736	54,905	54,253	54,707
Shumë e dhënë D**** H****	-	-	-	857,780	371,109	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet për apartamentin 27,000 Euro	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kthimi i huasë I**** H****	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Pasuri</b>	<b>1,761,167</b>	<b>4,182,861</b>	<b>228,519</b>	<b>39,783</b>	<b>488,776</b>	<b>3,673,995</b>	<b>1,008,131</b>	<b>329,788</b>	<b>77,215</b>	<b>3,922</b>	<b>280,333</b>	<b>770,409</b>	<b>1,421</b>	<b>49,157</b>	
Kursime (shitesa/pakësime likuiditeti)	2,261,167	3,824,719	1,063,585	2,433,217	488,776	16,005	322,281	329,788	6,162	3,922	87	196	1,421	49,157	
Apartament 115.9 m2 përfituar me kontratë shkëmbimi	-	-	1,192,104	2,473,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Garazh 19.4 m2 përfituar sipas kontratës së shmëbimit, në bashkëpronësi 50%	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Makinë Benz C-Class 2001, targë ***** blerë 11.10.2009	-	-	-	-	-	685,850	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Apartament 55 m2 përfituar me kontratë shitëbleje (ap. 1-1 plax h)	-	-	-	-	-	3,690,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Makinë Volkswagen***** blerë me 16.06.2014	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	770,605	-	-	-
Trua 11547.75 m2 në bashkëpronësi me 13 bashkëpronarë ligjorë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Autoveturë e tipit Mercedes Benz prodhim i vitit 1986, targë ****	500,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Dyqan 12m2 (Dyqan 23,79 m2 në b'pronësi R*** H*** M*** C**	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Apartament 2-1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Auto shkolla Glorjeta	-	-	100,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Automjeti Ford dhuruar nga G*** K***, targë *****	-	-	-	-	-	-	-	-	71,053	-	-	-	-	-	-
Automjeti Benz A*** K*** me targë *****	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	280,420	-	-	-	-
Makinë Benz 250D, vp 1992, targë ****	-	358,142	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Makinë Benz 250D, targë ****	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Të ardhura + detyrime - shpenzime - pasuri</b>		<b>2,009,668</b>	<b>- 1,746,922</b>	<b>- 187,423</b>	<b>- 128,537</b>	<b>681,969</b>	<b>- 5,136,781</b>	<b>- 616,648</b>	<b>288,637</b>	<b>121,950</b>	<b>243,433</b>	<b>143,655</b>	<b>- 256,151</b>	<b>448,544</b>	<b>- 13,885</b>

## **V. VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreut IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Eda Kaja:

- a. ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë;
- b. ka kryer deklaram të rremë të pasurisë dhe veprime fiktive;
- c. ka zhvilluar procese gjyqësore në situatë konflikti interesi;
- d. nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara nga punësimi i saj dhe personat e lidhur me të, nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruara, në shumën -8,086,347 lekë.

Bazuar në konkluzionet sa më sipër, si dhe në vlerësimin tërësor të procedurave, në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit Eda Kaja nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në pikat 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të pikës 1/c të nenit 58 dhe të dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Eda Kaja, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 16.11.2021.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Valbona SANXHAKTARI**  
Kryesuese

**Olsi KOMICI**  
Relator

**Xhensila PINE**  
Anëtare

*Sekretare gjyqësore*  
*Olsida Goxhaj*